



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.26

12 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.141, datë 11.2.2009	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve shtëpiake frigoriferike, ngrirësit dhe kombinimet e tyre, në lidhje me kërkesat e efijencës së energjisë”	1533
Vendim i KM nr.142, datë 11.2.2009	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, për përdorim në ambiente (atmosfera), potencialisht shpërthyesë”	1537
Vendim i KM nr.152, datë 11.2.2009	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e efijencës së energjisë për pajisjet e vogla elektronike (drosela) dhe ndriçim fluoreshent”	1555
Vendim i KM nr.218, datë 6.3.2009	Për disa shtesa në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes”, sh.a.”, të ndryshuar	1559

VENDIM
Nr.141, datë 11.2.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE SHTËPIAKE FRIGORIFERIKE,
NGRIRËSIT DHE KOMBINIMET E TYRE, NË LIDHJE ME KËRKESAT E EFIÇENCËS SË
ENERGJISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve shtëpiake frigoriferike, ngrirësit dhe kombinimet e tyre, në lidhje me kërkesat e efiçencës së energjisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet fillojnë 6 muaj pas hyrjes në fuqi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE
SHTËPIAKE FRIGORIFERIKE, NGRIRËSIT DHE KOMBINIMET E TYRE NË LIDHJE ME
KËRKESAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË

1. Ky rregull teknik zbatohet për pajisjet e reja elektroshtëpiake frigoriferike, dollapët ngrirës për ruajtjen e ushqimeve, ftohësit ushqimorë dhe kombinimet e tyre, siç përcaktohen në pikën 14, më poshtë “pajisje frigoriferike”.

2. Përjashtohen nga ky rregull teknik pajisjet, të cilat mund të përdorin burime të tjera energjie, veçanërisht akumulatorët, si dhe pajisjet shtëpiake frigoriferike që punojnë me parimin e absorbimit dhe pajisjet e prodhuara mbi bazën e një porositje, sipas specifikimeve të veçanta teknike për një pajisje të vetme.

3. Pajisjet frigoriferike, të cilat mbulohen nga ky rregull teknik vendosen në treg vetëm nëse konsumi i energjisë elektrike nga pajisja në fjalë, është më i vogël apo i barabartë me vlerën maksimale të lejuar të konsumit të energjisë elektrike, për këtë kategori nga llogaritja sipas procedurës së përcaktuar në pikën 14.

4. Fabrikuesi i pajisjes frigoriferike, që mbulohet nga ky rregull teknik, përfaqësuesi i tij i autorizuar, apo personi përgjegjës për vendosjen e pajisjes frigoriferike në treg, është përgjegjës për të siguruar që çdo pajisje e vendosur në treg është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 3.

5. Nuk ndalohet, kufizohet apo pengohet vendosja në treg e pajisjeve frigoriferike të cilat mbajnë markimin “CE”, që tregon përputhshmërinë e tyre me të gjitha kërkesat e këtij rregulli teknik.

6. Pajisjet frigoriferike, të cilat mbajnë markimin “CE” të kërkuar sipas pikave 10 dhe 11, prezumohen që plotësojnë të gjitha kërkesat e këtij rregulli teknik, nëse nuk ka prova për të kundërtën.

7. Kur pajisjet frigoriferike janë objekt i rregullave teknike të tjera, që mbulojnë aspekte të tjera dhe që parashikojnë, gjithashtu, vendosjen e markimit “CE”, kjo e fundit tregon që pajisja në fjalë prezumohet se është në përputhje edhe me dispozitat e këtyre rregullave teknike.

8. Kur një ose më shumë rregulla teknike lejojnë fabrikuesin, që gjatë një periudhe tranzitore, të zgjedhë se cilat rregulla do të zbatojë, markimi “CE” do të tregojë përputhjen vetëm me kërkesat e rregullave teknike që ka zbatuar fabrikuesi. Në këtë rast, referencat e vendimeve të Këshillit të Ministrave, për rregullat teknike të zbatuara, të publikuara në Fletoren Zyrtare, jepen në dokumentet, njoftimet apo instruksionet që shoqërojnë pajisjet frigoriferike.

9. Procedurat e vlerësimit të konformitetit (moduli A) dhe detyrimet në lidhje me markimin “CE” të pajisjeve frigoriferike jepen si më poshtë:

a) Moduli A përshkruan procedurat me anë të së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, që zbaton detyrimet e dhëna në paragrafin b të pikës 9, garanton dhe deklaron që pajisja frigoriferike plotëson kërkesat përkatëse të këtij rregulli teknik. Fabrikuesi vendos markimin “CE” te çdo pajisje frigoriferike, të cilën ai e prodhon dhe harton me shkrim një deklaratë konformiteti.

b) Fabrikuesi krijon dosjen teknike të përshkruar në paragrafin c, pika 9, dhe ai ose përfaqësuesi i tij i autorizuar e mban këtë dosje në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, për qëllime inspektimi, për një periudhë jo më pak se 3 vjet nga data e prodhimit të pajisjes së fundit.

Kur fabrikuesi dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk ndodhen në Shqipëri, detyrimi për mbajtjen në dispozicion të dosjes teknike, është përgjegjësi e personit që vendos pajisjen frigoriferike në treg.

c) Dosja teknike duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të pajisjes frigoriferike me kërkesat e këtij rregulli teknik. Një vlerësim i tillë mbulon projektimin, prodhimin dhe funksionimin e pajisjes frigoriferike, duke përfshirë:

- i) emrin dhe adresën e fabrikuesit;
- ii) përshkrimin e përgjithshëm të modelit në mënyrë të mjaftueshme për një identifikim të qartë;
- iii) informacionin, që përfshin skicimet, veçoritë kryesore të projektimit të modelit dhe veçanërisht të elementeve, të cilat ndikojnë ndjeshëm në konsumin e energjisë elektrike nga ana e tij, siç janë përmasat, vëllimi(et), karakteristikat e kompresorit, tipare të veçanta etj.;

- iv) udhëzimet e funksionimit, nëse ka;

- v) rezultatet e matjeve të konsumit të energjisë elektrike të kryera sipas kërkesave të paragrafit “e” të kësaj pike;

- vi) detaje të përputhjes së këtyre matjeve krahasuar me kërkesat e konsumit të energjisë të përcaktuara në pikën 14.

d) Dosja teknike e krijuar në përputhje me kërkesat e rregullave teknike të tjera, mund të përdoret për sa kohë ajo plotëson edhe kërkesat e pikës 9.


e) Fabrikuesit e pajisjeve frigoriferike janë përgjegjës për përcaktimin e konsumit të energjisë në çdo pajisje frigoriferike në përputhje me procedurat e specifikuara në standardin SSHEN 153, ose standardeve të tjera të barasvlershme me të, si edhe për përputhshmërinë e pajisjeve me kërkesat e pikave 3 dhe 4.

f) Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban një kopje të deklaratës së konformitetit së bashku me dosjen teknike.

g) Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme me qëllim që procesi i prodhimit të garantojë që, pajisjet frigoriferike të prodhuara të jenë në përputhje me dosjen teknike, të përcaktuara në paragrafin b, të pikës 9 dhe me kërkesat përkatëse të këtij rregulli teknik.

10. Kur pajisjet vendosen në treg ato duhet të mbajnë markimin “CE”, e cila përbëhet nga inicialet “CE”. Markimi “CE” vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme te pajisjet frigoriferike dhe kur është e mundur edhe te paketimi i tyre.

a) Markimi “CE” ka formën e mëposhtme:



b) Nëse markimi “CE” zvogëlohet ose zmadhohet, raportet e dhëna në figurën e mësipërme duhet të respektohen në mënyrë përpjesëtimore.

c) Komponentët e ndryshëm të markimit “CE” duhet të kenë kryesisht të njëjtin dimensionin vertikal, të cilët nuk duhet të jenë më pak se 5 mm.

d) Rrjeta e dhënë në sfond të figurës së mësipërme nuk është pjesë e markës “CE”.

11. Ndalohet vendosja e çdo lloj marke në pajisjet frigoriferike, e cila ka mundësi të shkaktojë keqkuptime te palët e treta për sa i përket kuptimit dhe formës së markimit “CE”. Çdo markë tjetër mund të vendoset në këto pajisje, në paketimet e tyre, në fletën e instruksionit apo dokumente të tjera, por duke garantuar që markimi “CE” të mbetet i dukshëm dhe i lexueshëm.

12. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut gjen se markimi ‘CE’ është vënë në mënyrë jokorrekte, fabrikuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar është i detyruar të sjellë produktin në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe t’i japë fund shkeljes. Në rastet kur fabrikuesi dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk janë të vendosur në Shqipëri, këto detyrime bien mbi personin, i cili ka vendosur në treg

pajisjet frigoriferike.

13. Në rast se produkti vazhdon të jetë në mospërputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut ndërmerr masat referuar ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve jo ushqimore”.

14. Metoda e llogaritjes për konsumin maksimal të lejuar të energjisë së pajisjeve frigoriferike dhe procedurat e kontrollit të konformitetit kryhen si më poshtë:

a) Konsumi i energjisë elektrike i një pajisjeje frigoriferike, e shprehur në kwh për 24 orë, është një funksion i kategorisë së cilës i përket pajisja si p.sh. frigorifer i klasit me një yll (*), dollap ngrirës etj.; i vëllimit të saj dhe efikasitetit të energjisë së konstruksionit të saj, (trashësisë së izolimit, efikasitetit të kompresorit etj.); dhe diferencës midis temperaturës së ambientit dhe temperaturës brenda pajisjes. Në përcaktimin e standardeve të efikasitetit të energjisë, duhet bërë tolerancë për faktorët e brendshëm kryesorë, të cilët influencojnë në konsumin e energjisë (si p.sh. kategoria e pajisjeve dhe vëllimi i tyre).

Maksimumi i lejuar i konsumit të energjisë elektrike të një pajisjeje frigoriferike, përcaktohet me anën e një ekuacioni linear, i cili është një funksion i vëllimit të pajisjes me ekuacione të ndryshme të dhëna për çdo kategori të pajisjes.

b) Për të llogaritur maksimumin e lejuar të konsumit të energjisë elektrike të një pajisjeje të dhënë, së pari përcaktohet kategoria përkatëse nga lista e mëposhtme:

Kategoria	Përshkrimi
1	Frigorifer, pa dhomëz me temperaturë të ulët ⁽¹⁾
2	Frigorifer/ftohës, me dhomëz me 5°C dhe/ose 12° C
3	Frigorifer, me dhomëz të temperaturës së ulët (pa *)
4	Frigorifer, me dhomëz me temperaturë të ulët (me një *)
5	Frigorifer, me dhomëz me temperaturë të ulët (me dy *)
6	Frigorifer, me dhomëz me temperaturë të ulët (me tre ***)
7	Frigorifer/ngrirës me dhomëz ngrirëse (me katër ****)
8	Ngrirës ushqimor, vertikal
9	Ngrirës ushqimor, në formë sënduku
10	Frigorifer/ ngrirës që ka më shumë se dy dyer ose pajisje të tjera që nuk janë përfshirë më sipër

⁽¹⁾ çdo dhomëz me temperaturë me ose nën -6°C.

c) Meqenëse pajisjet frigoriferike kanë dhomëza të ndryshme që mbahen në temperatura të ndryshme (të cilat influencojnë ndjeshëm në konsumin e energjisë elektrike), maksimumi i lejuar i konsumit të kësaj energjie përcaktohet në praktikë si një funksion i vëllimit të përshtatur, që është sa shumatorja e ponderuar e vëllimeve të dhomëzave të ndryshme.

d) Si rrjedhim, për qëllime të kësaj direktive, vëllimi i përshtatur (V_p) i një pajisjeje frigoriferike përcaktohet si:

$$V_p = \sum V_c \times W_c \times F_c \times C_c$$
$$W_c = (25 - T_c)/20$$

- ku T_c është temperaturë e konstruksionit të secilës dhomëz në (°C).

- ku V_c është vëllimi neto i tipit të dhomëzës së pajisjes dhe F_c është një faktor që merret 1,2 për dhomëzat joftohëse dhe 1 për dhomëzat e tjera.

- C_c = 1 për pajisjet frigoriferike që i përkasin klasave klimatike normale (N) dhe subnormale (SN).

- C_c = X_c për pajisjet frigoriferike që i përkasin klasës klimatike subtropikale (ST).

- C_c = Y_c për pajisjet frigoriferike që i përkasin klasës klimatike tropikale (T).

e) Koeficienti i peshës X_c dhe Y_c për tipe të ndryshme dhomëzash është:

Tabela e koeficientit të peshës X_c dhe Y_c sipas temperaturës së dhomëzës:

	X _c	Y _c
Dhomëzat e tipit bodrum/qilar	1,25	1,35
Dhomëzat për ushqime të freskëta	1,20	1,30
Dhomëzat për 0°C	1,15	1,25
Dhomëzat pa yje	1,15	1,25
Dhomëzat me 1 yll (*)	1,12	1,20

Dhomëzat me 2 yje (**)	1,08	1,15
Dhomëzat me 3(***) dhe 4 (****) yje	1,05	1,10

f) Si vëllimi i përshtatur, ashtu edhe vëllimi neto shprehen në litra.

g) Konsumi i energjisë elektrike maksimale të lejuar (E_{max} e shprehur në kWh për 24 orë i llogaritur deri në dy numra pas presjes dhjetore) për një tip pajisjeje me vëllimin e përshtatur V_p përcaktohet nga ekuacionet e mëposhtme për çdo kategori pajisjeje:

Kategoria	Përshkrimi	E_{max} (kWh/24 orë)
1	Frigorifer, pa dhomëz me temperaturë të ulët (¹)	$(0,207 \times V_p + 218) / 365$
2	Frigorifer/ftohës, me dhomëz me 5°C dhe/ose 12° C	$(0,207 \times V_p + 218) / 365$
3	Frigorifer, me dhomëz pa yje të temperaturës së ulët	$(0,207 \times V_p + 218) / 365$
4	Frigorifer, me dhomëz me temperaturë të ulët (*)	$(0,557 \times V_p + 166) / 365$
5	Frigorifer, me dhomëz me temperaturë të ulët (**)	$(0,402 \times V_p + 219) / 365$
6	Frigorifer, me dhomëz me temperaturë të ulët (***)	$(0,573 \times V_p + 206) / 365$
7	Frigorifer/ngrirës me dhomëz ngrirëse (****)	$(0,697 \times V_p + 272) / 365$
8	Ngrirës ushqimor, vertikal	$(0,434 \times V_p + 262) / 365$
9	Ngrirës ushqimor, tip sënduk	$(0,408 \times V_p + 195) / 365$

gj) Për frigoriferët/ngrirësit që kanë më shumë se dy dyer ose pajisje të tjera që nuk përfshihen më sipër, maksimumi i lejuar i konsumit të energjisë elektrike (E_{max}) përcaktohet nga temperatura dhe klasa e yjeve të dhomëzave me temperaturë të ulët si më poshtë:

Temperatura e dhomëzës më të ftohtë	Kategoria	E_{max} (kWh/24 orë)
> - 6 °C	1 / 2 / 3	$(0,207 \times V_p + 218) / 365$
≤ - 6 °C (*)	4	$(0,557 \times V_p + 166) / 365$
≤ - 12 °C (**)	5	$(0,402 \times V_p + 219) / 365$
≤ - 18 °C (***)	6	$(0,573 \times V_p + 206) / 365$
≤ - 18 °C (****)	7	$(0,697 \times V_p + 272) / 365$

h) Procedurat e testit për të kontrolluar nëse një pajisjeje përputhet me kërkesat e konsumit të energjisë elektrike sipas këtij rregulli teknik.

i) Në rast se konsumi i energjisë elektrike të një pajisjeje frigoriferike e paraqitur për verifikim, është më i vogël ose i barabartë me E_{max} plus 15%, pajisja certifikohet në konformitet me kërkesat e konsumit të energjisë elektrike të këtij rregulli teknik.

ii) Në rast se konsumi i energjisë elektrike të pajisjes është më i madh se E_{max} plus 15%, konsumi i energjisë elektrike duhet të rimatet edhe për tri pajisje të tjera. Nëse mesatarja aritmetike e konsumit të energjisë elektrike të këtyre tri pajisjeve është më e vogël ose e barabartë me E_{max} plus 10%, pajisja certifikohet në konformitet me kërkesat e konsumit të energjisë elektrike të këtij rregulli teknik. Nëse mesatarja aritmetike e kalon E_{max} plus 10%, pajisja vlerësohet jo në konformitet me kërkesat e konsumit të energjisë elektrike të këtij rregulli teknik.

i) Termat e përdorur në pikën 14 u korrespondojnë përcaktimeve të standardit SSHEN 153 ose standardeve të tjera të barasvlershme me të.

VENDIM Nr.142, datë 11.2.2009

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE DHE SISTEMEVE MBROJTËSE, PËR
PËRDORIM NË AMBIENTE (ATMOSFERIKE), POTENCIALISHT SHPËRTHYESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, për përdorim në ambiente (atmosfera), potencialisht shpërthyes”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet për zbatimin e tij fillojnë nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULL TEKNIK PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT MBI PAJISJET DHE SISTEMET MBROJTËSE PËR PËRDORIM NË AMBIENTE (ATMOSFERË) POTENCIALISHT SHPËRTHYESE

1. Fusha e zbatimit

1.1 Ky rregull teknik zbatohet për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që parashikohen të përdoren në atmosfera potencialisht shpërthyes.

1.2 Fusha e zbatimit të këtij rregulli teknik mbulon edhe mjetet e sigurisë, mjetet e kontrollit dhe mjetet e rregullimit të parashikuara për përdorim jashtë atmosferave potencialisht shpërthyes, por që janë të nevojshme ose që ndihmojnë në funksionimin e sigurt të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtës për sa u përket rreziqeve të shpërthimit.

2. Përkufizime

Për qëllime të këtij rregulli teknik zbatohen përcaktimet e mëposhtme:

“Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të parashikuara për përdorim në atmosferë potencialisht shpërthyes”.

a) Me “pajisje” nënkuptohen makineri, aparatura, mekanizma të fiksuar ose të lëvizshëm, komponentë të komandimit e të kontrollit dhe sisteme të zbulimit e të parandalimit, të cilat, veç e veç ose së bashku, janë të parashikuara për t’u përdorur në proceset e prodhimit, transferimit, depozitimit, matjes, kontrollit dhe shndërrimit të energjisë për përpunimin e materialeve, që si pasojë e burimeve të tyre karakteristike potenciale ndezëse, rrezikojnë të shkaktojnë një shpërthim.

b) Me “sisteme mbrojtëse” nënkuptohen pajisje speciale të projektuara që parashikohen ta bllokojnë shpërthimin në fazën e tyre fillestare dhe/ose të kufizojnë zonën e flakëve dhe presionet e shpërthimit. Sistemet mbrojtëse mund të jenë instaluar në pajisje ose vendosen në treg për përdorim më vete, si sisteme të pavarura.

c) Me “komponentë” nënkuptohet çdo element thelbësor në funksionimin e sigurt të pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, por që nuk funksionojnë si të pavarura.

d) “Atmosferë shpërthyes” është përzierja në ajër, në kushte atmosferike, e substancave të ndezshme në formën e gazeve, avujve, tymrave ose pluhurave në të cilën, pasi ka ndodhur ndezja, djegia përhapet në të tërë përzierjen e padjegur.

e) “Atmosfera potencialisht shpërthyes” është një atmosferë, e cila mund të bëhet shpërthyes për shkak të kushteve lokale dhe operacionale.

f) Grupet dhe kategoritë e pajisjeve

i) Grupi I pajisjeve përbëhet nga pajisjet e parashikuara të përdoren në mjediset nëntokësore të minierave dhe në ato pjesë të instalimeve në sipërfaqe të këtyre minierave, të prirura të jenë të rrezikuara nga gazet shpërthyes dhe/ose pluhuri i djegshëm.

ii) Grupi II i pajisjeve përbëhet nga pajisjet e parashikuara për përdorim në vende të tjera të prirura të jenë të rrezikuara nga atmosfera shpërthyes.

Kategoritë e pajisjeve që karakterizohen nga nivele të kërkuara mbrojtëse janë përshkruar në pikën 8.

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse mund të projektohen për një atmosferë të veçantë shpërthyes. Në këtë rast ato duhet të markohen në përputhje me të.

g) “Përdorimi i parashikuar” është përdorimi i pajisjeve, sistemeve mbrojtëse dhe mjeteve të referuara në pikën 1.2, në përputhje me grupin dhe kategorinë e pajisjes dhe me të gjithë informacionin e dhënë nga fabrikuesi që kërkohet për funksionimin e sigurt të pajisjeve, sistemeve mbrojtëse dhe mjeteve.

3. Përrjashtime

Përrjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij rregulli teknik:

- a) pajisjet mjekësore të parashikuara për përdorim në një mjedis mjekësor;
- b) pajisjet dhe sistemet mbrojtëse ku rreziku i shpërthimit rezulton vetëm nga prania e substancave shpërthyes ose e substancave kimike të paqëndrueshme;
- c) pajisjet e parashikuara për përdorim në mjedise shtëpiake dhe jotregtare ku atmosferat potencialisht shpërthyes mund të krijohen rrallë dhe vetëm si rezultat i një rrjedhjeje aksidentale të gazit djegës;
- d) mjetet e mbrojtjes personale;
- e) anijet detare dhe njësi të lëvizshme detare, së bashku me pajisjet mbi bordin e tyre;
- f) mjetet e transportit si automjete dhe trailerat e tyre të parashikuara vetëm për transportin ajror, rrugor, ujor apo hekurudhor të pasagjerëve apo të mallrave. Nuk përrjashtohen mjetet e transportit të parashikuara për përdorim në një atmosferë potencialisht shpërthyes;

g) pajisjet për qëllime ushtarake.

4. Vendosja në treg dhe/ose shërbim

a) Pajisjet, sistemet mbrojtëse dhe mjetet e referuara në pikën 1.2, për të cilat zbatohet ky rregull teknik, vendosen në treg ose në shërbim vetëm në qoftë se ato janë instaluar korrektësisht, mirëmbahen dhe përdoren sipas qëllimit të parashikuar dhe nuk rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e njerëzve dhe, sipas rastit, të kafshëve shtëpiake, apo të pronës.

b) Pajisjet, sistemet mbrojtëse dhe mjetet e referuara në pikën 1.2, të cilat nuk janë në përputhje me kushtet e këtij rregulli teknik mund të vendosen në panairë, ekspozita, demonstrime etj., vetëm me kushtin që një shënim qartësisht i dukshëm të tregojë se këto pajisje, sisteme mbrojtëse dhe mjete nuk janë në përputhje me këtë rregull teknik dhe që ato nuk shiten deri sa të sillen në përputhje me të nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar. Gjatë demonstrimeve merren masat e sigurisë për të garantuar mbrojtjen e personave.

5. Lëvizja e lirë

5.1 Pajisjet, sistemet mbrojtëse dhe mjetet e referuara në pikën 1.2, për të cilat zbatohet ky rregull teknik, duhet të plotësojnë kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në pikën 9, duke pasur parasysh qëllimin e përdorimit të tyre.

5.2 Nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg dhe/ose në shërbim:

a) e pajisjeve, sistemeve mbrojtëse të referuara në pikën 1.2, të cilat janë në përputhje me këtë rregull teknik;

b) e komponentëve, të cilët parashikohen të përfshihen në pajisje ose sisteme mbrojtëse në kuptim të këtij rregulli teknik, kur ato shoqërohen nga një certifikatë e konformitetit siç referohet në pikën 6.3.

5.3 Konsiderohen në përputhje me kushtet e këtij rregulli teknik, duke përfshirë dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit të dhëna në pikën 9:

a) pajisjet, sistemet mbrojtëse dhe mjetet e referuara në pikën 1.2 që shoqërohen nga deklarata EC e konformitetit, si referohet në pikën 17 dhe nga markimi “CE” e dhënë në pikën 7;

b) komponentët e referuar në pikën 5.2 b) shoqërohen nga certifikata e konformitetit si referohet në pikën 6.3.

5.4 Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut konstaton se:

a) pajisjet, sistemet ose mjetet e referuara në pikën 1.2 që kanë markimin “CE” dhe përdoren sipas qëllimit të parashikuar, rrezikojnë sigurinë e personave dhe sipas rastit të kafshëve shtëpiake dhe pronës, merr të gjitha masat përkatëse për tërheqjen nga tregu, ndalimin e vendosjes në treg dhe/ose në shërbim apo përdorim, ose kufizon lëvizjen e lirë të tyre;

b) kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut konstaton se pajisje ose sisteme mbrojtëse nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe janë me markimin “CE”, merr të gjitha masat administrative dhe ndalimin e bërjes së disponueshme të tyre në treg në bazë të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007.

6. Procedurat e vlerësimit të konformitetit

6.1 Procedurat për vlerësimin e konformitetit të pajisjeve, duke përfshirë, kur nevojitet, edhe të mjeteve të referuara në pikën 1.2 janë si më poshtë:

6.1.1 Për pajisjet e kategorisë M1 të grupit I të pajisjeve dhe kategorisë 1 të grupit II të pajisjeve sipas klasifikimit në pikën 8:

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për vendosjen e markimit “CE” duhet të ndjekë procedurën e shqyrtimit “CE” të tipit siç referohet në pikën 10, lidhur me:

- a) procedurën për sigurimin e cilësisë së prodhimit siç referohet në pikën 11; ose
- b) procedurën mbi verifikimin e produktit siç referohet në pikën 12.

6.1.2 Për pajisjet e kategorisë M2 të grupit I dhe kategorisë 2 të grupit II të pajisjeve sipas klasifikimit në pikën 8:

a) Në rastin e motorëve me djegie të brendshme dhe pajisjeve elektrike që përfshihen në këto grupe dhe kategori, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për vendosjen e markimit “CE” duhet të ndjekë procedurën e shqyrtimit CE të tipit siç referohet në pikën 10 lidhur me:

- i) procedurën mbi konformitetin e tipit siç referohet në pikën 13; ose
- ii) procedurën mbi sigurimin e cilësisë së produktit siç referohet në pikën 14.

b) Në rastin e pajisjeve të tjera që përfshihen në këto grupe dhe kategori, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për vendosjen e markimit “CE” ndjek procedurën e kontrollit të brendshëm të prodhimit, siç referohet në pikën 15, dhe i dorëzon një organi të autorizuar/organizëm i regjistruar evropian për vlerësimin e konformitetit (më poshtë organizëm evropian) dokumentacionin siç parashikohet në pikën 15.3, i cili e mban atë dhe i konfirmon menjëherë fabrikuesit marrjen e tij.

6.1.3 Për pajisjet e kategorisë 3 të grupit II të pajisjeve

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për vendosjen e markimit “CE” duhet të ndjekë procedurën e kontrollit të brendshëm të prodhimit siç referohet në pikën 15.

6.1.4 Për grupet I dhe II të pajisjeve

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për vendosjen e markimit “CE”, përveç procedurave të referuara në pikën 6.1.1, 6.1.2 dhe 6.1.3, mund të ndjekë edhe procedurën për verifikimin CE të njësisë siç referohet në pikën 16.

6.2 Kushtet e referuara në pikën 6.1.1 ose 6.1.4 përdoren për vlerësimin e konformitetit të sistemeve të pavarura mbrojtëse.

6.3 Procedurat e referuara në pikën 6.1 zbatohen në lidhje me komponentët e referuar në pikën 4.2, por duke përjashtuar vendosjen e markimit “CE”. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar me anën e një certifikate deklaron konformitetin e komponentëve me kushtet e këtij rregulli teknik që zbatohen ndaj tyre, si dhe përcakton karakteristikat e tyre dhe se si ato duhet të instalohen në pajisjet ose në sistemet mbrojtëse për të mbështetur përputhjen me kërkesat thelbësore të zbatueshme në pajisjen apo sistemet mbrojtëse të përfunduara.

6.4 Për më tepër, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar për vendosjen e markimit “CE” mund të ndjekë edhe procedurën e kontrollit të brendshëm të prodhimit (siç referohet në pikën 15 në lidhje me aspektet e sigurisë që referohen në pikën 9.1.2.7).

Autoritetet kompetente, me një kërkesë të justifikur në kohën e duhur, autorizojnë vendosjen në treg dhe/ose në shërbim të pajisjes, sistemeve mbrojtëse dhe mjeteve individuale të referuara në pikën 1.2 kur procedurat e referuara në paragrafët e mësipërm nuk janë zbatuar dhe përdorimi i tyre është në interes të mbrojtjes.

6.5 Dokumentet dhe korrespondenca lidhur me procedurat siç referohen në paragrafët e mësipërm hartohen në shqip ose në një nga gjuhët zyrtare evropiane të pranura nga organi i autorizuar/organizmi evropian.

6.6 Ministri përgjegjës për industrinë autorizon organet për kryerjen e procedurave referuar në pikën 6. Këto organe duhet të jenë të akredituara dhe të plotësojnë kriteret minimale të përcaktuara në pikën 18.

6.7 Zbatimi i rregullave të tjera teknike

a) Kur pajisjet dhe sistemet mbrojtëse janë subjekt dhe i rregullave të tjera teknike që mbulojnë aspekte të tjera, të cilat gjithashtu parashikojnë vendosjen e markimit “CE” të referuar në pikën 7, markimi tregon se pajisja dhe sistemet mbrojtëse janë gjithashtu të prezumuara në përputhje me kushtet e këtyre rregullave teknike.

b) Kur një ose me shumë nga këto rregulla teknike i lejojnë fabrikuesit që gjatë një periudhe të ndërmjetme të zgjedhë se cilin rregull të zbatojë, markimi “CE” tregon përputhjen vetëm me rregullat teknike të zbatuara nga fabrikuesi. Në këtë rast, hollësitë e rregullave të tjera teknike të publikuara në Gazetën Zyrtare duhet të jepen në dokumentet, njoftimet ose instruksionet e kërkuara nga rregullat teknike dhe që shoqërojnë pajisjet dhe sistemet mbrojtëse.

7. Markimi “CE” i konformitetit

a) Markimi “CE” i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE”. Forma e markimit që përdoret jepet

në pikën 17. Markimi “CE” shoqërohet nga numri i identifikimit të organit të autorizuar/organizmit europian që është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit.

b) Markimi “CE” vendoset në mënyrë të qartë, të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në pajisjet dhe në sistemet mbrojtëse duke shtuar dhe kërkesat e pikës 9.1.0.5.

c) Ndalohet vendosja mbi pajisjet ose sistemet mbrojtëse të markimeve, të cilat mund të çorientojnë palë të treta si në kuptimin, ashtu dhe formën e markimit “CE”. Çdo markim tjetër mund të vendoset në pajisjet ose në sistemet mbrojtëse me kusht që të mos ulet dukshmëria dhe lexueshmëria e markimit “CE”.

8. Kriteret që përcaktojnë klasifikimin e grupeve të pajisjeve në kategori

8.1 Pajisjet e grupit I

a) Kategoria M1 përfshin pajisjet e projektuara dhe, ku është e nevojshme, të pajisura me mjete të tjera të veçanta mbrojtëse, që të jenë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat operacionalë të vendosura nga fabrikuesi dhe që sigurojnë një nivel shumë të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie parashikohen për përdorim në ambiente nëntokësore të minierave, si dhe në ato pjesë të instalimeve në sipërfaqe të këtyre minierave që rrezikohen nga gazet shpërthyes dhe/ose nga pluhurat që marrin zjarr.

Pajisjet e kësaj kategorie kërkohen të mbeten funksionale në prani të një atmosfere shpërthyes, edhe në rastin e defekteve të rralla të pajisjes, dhe karakterizohen nga mjete mbrojtëse të tilla që:

i) në rast dëmtimi të një prej mjeteve mbrojtëse, të paktën një mjet i dytë mbrojtës, i pavarur, siguron nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes; ose

ii) niveli i domosdoshëm i mbrojtjes është i garantuar edhe në rastin e dy defekteve të ndodhura në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të plotësojnë kërkesat suplementare të referuara në pikën 9.2.0.1.

b) Kategoria M2 përfshin pajisjet e projektuara që të jenë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat operacionalë të vendosura nga fabrikuesi dhe që sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie janë të parashikuara të përdoren në mjedise nëntokësore të minierave, si dhe po aq mirë, edhe në ato pjesë të instalimeve në sipërfaqe, në këto miniera, që mund të rrezikohen nga gazet shpërthyes dhe/ose nga pluhurat e ndezshëm.

Kjo pajisje parashikohet të ç’aktivizohet në rastin e një atmosfere shpërthyes.

Mjetet e mbrojtjes të lidhura me pajisjet e kësaj kategorie sigurojnë nivelin e kërkuar të mbrojtjes si gjatë funksionimit normal, ashtu edhe në rastin e kushteve më të ashpra funksionale, veçanërisht në ato të lindura nga shfrytëzimi i keq dhe ndryshimi i kushteve të atmosferës.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të plotësojnë kërkesat suplementare të referuara në pikën 9.2.0.2.

8.2 Pajisjet e grupit II

a) Kategoria 1 përfshin pajisjet e projektuara që të jenë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat operacionalë të vendosura nga fabrikuesi dhe që sigurojnë një nivel shumë të lartë mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie parashikohen për përdorim në mjedise ku atmosferat shpërthyes të shkaktuara nga përzierjet e ajrit dhe gazeve, avujve apo tymrave ose nga përzierjet ajër/pluhura janë të pranishme, vazhdimisht, për periudha të gjata apo shpeshherë.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të sigurojnë nivelin e domosdoshëm të mbrojtjes edhe në rastin e anomalive të rralla që lidhen me këto pajisje dhe karakterizohen nga mjete mbrojtjeje të tilla që:

i) në rastin e defektimit të njërit prej mjeteve mbrojtëse, të paktën një mjet i dytë mbrojtës, i pavarur siguron nivelin e domosdoshëm të kërkuar të mbrojtjes; ose

ii) të sigurohet niveli i domosdoshëm i mbrojtjes edhe në rastin e dy defekteve të ndodhura në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet t’i plotësojnë kërkesat suplementare të referuara në pikën 9.2.1.

b) Kategoria 2 përfshin pajisjet e projektuara që të jenë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat operacionalë të vendosur nga prodhuesi dhe që sigurojnë një nivel të lartë të mbrojtjes.

Pajisjet e kësaj kategorie parashikohen për përdorim në mjedise në të cilat atmosferat shpërthyes mund të shkaktohen nga gazet, avujt, tymrat ose nga përzierjet ajër/pluhura.

Mjetet mbrojtëse të lidhura me pajisjet e kësaj kategorie sigurojnë nivelin e domosdoshëm të kërkuar të mbrojtjes edhe në rastin e ndodhjes së anomalive të shpeshta ose defekteve të pajisjes, të cilat normalisht duhet të merren parasysh.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet t’i plotësojnë kërkesat suplementare të referuara në pikën 9.2.2.

c) Kategoria 3 përfshin pajisjet e projektuara që janë në gjendje të funksionojnë në përputhje me parametrat operacionalë të vendosur nga fabrikuesi dhe që sigurojnë një nivel normal mbrojtjeje.

Pajisjet e kësaj kategorie parashikohen për përdorim në mjedise ku atmosferat shpërthyes të

shkaktuara nga gazet, avujt, tymrat ose nga përzierjet ajër/pluhura ka pak të ngjarë që të ndodhin, por edhe nëse ato ndodhin, ndodhin vetëm rastësisht dhe vetëm për një kohë të shkurtër.

Pajisjet e kësaj kategorie sigurojnë një nivel të domosdoshëm të kërkuar mbrojtjeje gjatë një funksionimi normal.

Pajisjet e kësaj kategorie duhet të plotësojnë kërkesat suplementare të referuara në pikën 9.2.3.

9. Kërkesat thelbësore mbi shëndetin dhe sigurinë në lidhje me projektimin dhe ndërtimin e pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse të parashikuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes.

Vërejtje paraprake

A. Njohuritë teknologjike, të cilat ndryshojnë në mënyrë të shpejtë, duhet të merren në konsideratë sa të jetë e mundur dhe të shfrytëzohen menjëherë.

B. Për mjetet e referuara në pikën 1.2, kërkesat thelbësore zbatohen vetëm nëse ato janë të nevojshme për përdorimin dhe funksionimin e sigurt dhe të besueshëm përsa i përket rrezikut të shpërthimit.

9.1 Kërkesat e zakonshme për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse

9.1.0 Kërkesa të përgjithshme

9.1.0.1 Parimet e sigurisë së plotë ndaj shpërthimit.

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të parashikuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes duhet të projektohen sipas parimit të sigurisë së plotë ndaj shpërthimeve.

Në këtë kuptim fabrikuesi duhet të marrë masa që:

a) para së gjithash, nëse është e mundur, të parandalojë formimin e atmosferave shpërthyes, të cilat mund të prodhohen ose çlirohen nga vetë pajisjet ose sistemet mbrojtëse;

b) të parandalojë ndezjen në atmosferat shpërthyes duke pasur parasysh natyrën e çdo burimi elektrik ose joelektrik të ndezjes;

c) edhe nëse një shpërthim mund të ndodhë, që direkt ose indirekt mund të rrezikojë njerëz dhe sipas rastit kafshë shtëpiake apo prona, ta ndalojë atë menjëherë dhe/ose ta kufizojë shpërndarjen e flakëve dhe presionet e shpërthimit në një nivel të mjaftueshëm të sigurisë.

9.1.0.2 Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të projektohen dhe ndërtohen pas analizave të duhura të të gjitha gabimeve apo defekteve të mundshme që mund të lindin gjatë funksionimit, për të parandaluar, sa më shumë që të jetë e mundur, situatat e rrezikshme.

9.1.0.3 Kushte të veçanta kontrolli dhe mirëmbajtjeje

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që janë subjekt i kushteve të veçanta të kontrollit dhe mirëmbajtjes duhet të projektohen dhe ndërtohen duke i pasur parasysh këto kushte.

9.1.0.4 Kushtet e mjedisit rrethues

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të projektohen dhe ndërtohen në varësi të kushteve aktuale ose të parashikuara të mjedisit rrethues.

9.1.0.5 Markimi

Të gjitha pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të markohen në mënyrë të qartë dhe të paheqshme, së paku me të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit;

b) markimin “CE”;

c) emërtimin e serisë ose të tipit;

d) numrin serial, nëse ka;

e) vitin e ndërtimit;

f) markën e veçantë të mbrojtjes ndaj shpërthimit të ndjekur nga simboli i grupit dhe i kategorisë së pajisjes;



g) germa “G” për pajisjet e grupit II, (që lidhet me atmosferat shpërthyes nga gazet, avujt ose tymrat);

dhe/ose germa “D” (që lidhet me atmosferat shpërthyes të shkaktuara nga pluhurat).

Përveç kësaj, ku është e nevojshme, ato duhet të markohen edhe me të gjithë informacionin

kryesor mbi përdorimin e sigurt të tyre.

9.1.0.6 Instruksionet e përdorimit

a) Të gjitha pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të shoqërohen nga instruksionet e përdorimit, të cilat përbajnë së paku të dhënat e mëposhtme:

i) një përsëritje të informacionit me të cilin pajisja ose sistemi mbrojtës është markuar, duke përjashtuar numrin serial (shiko 9.1.0.5), së bashku me çdo informacion tjetër të duhur për të lehtësuar mirëmbajtjen (p.sh. adresat e importuesit, riparuesit etj);

ii) instruksionet mbi sigurinë;

iii) vendosjen në shërbim;

iv) përdorimit;

v) montimin dhe çmontimin;

vi) mirëmbajtjen (shërbimi dhe riparimi emergjent);

vii) instalimin;

viii) rregullimin;

ix) kur është e nevojshme, të dhëna mbi zonat e rrezikshme që gjenden pranë vend shkarkimeve të presionit;

x) kur është e nevojshme, instruksionet e formimit profesional/trajnitimit;

xi) detajime që lejojnë marrjen e një vendimi jashtë çdo dyshimi, nëse një pajisje e një kategorie të veçantë apo një sistem mbrojtës mund të përdoret pa asnjë rrezik në vendin e parashikuar dhe në kushte të parashikuara funksionimi;

xii) parametrat elektrikë dhe të presionit, temperaturat maksimale në sipërfaqe dhe vlera të tjera të përcaktuara;

xiii) ku është e nevojshme, kushte specifike, përdorimi, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e keq të mundshëm, që eksperiencat e ka treguar se mund të ndodhin;

xiv) atje ku kërkohet, karakteristikat thelbësore të mjeteve, të cilat mund të montohen me pajisjen ose sistemin mbrojtës.

b) Instruksionet duhet të hartohen në shqip dhe në një nga gjuhët zyrtare europiane.

Përpara vendosjes në shërbim të gjitha pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të shoqërohen nga një përkthim i instruksioneve në gjuhën shqipe, si dhe nga instruksionet në gjuhën origjinale.

Ky përkthim duhet të bëhet ose nga fabrikuesi, ose nga përfaqësuesi i tij i autorizuar, apo nga personi që vendos në tregun shqiptar pajisjen ose sistemin mbrojtës.

c) Instruksionet duhet të përmbajnë vizatime dhe diagrama të nevojshme për vendosjen në shërbim, mirëmbajtjen, inspektimin, kontrollin e funksionimit korrekt dhe kur kërkohet edhe për riparimin e pajisjes apo të sistemit mbrojtës, së bashku me të gjitha instruksionet e nevojshme për përdorimin, veçanërisht në lidhje me sigurinë.

d) Dokumentacioni që përshkruan pajisjen apo sistemin mbrojtës duhet të mos jetë kontradiktor me instruksionet e lidhura me aspektet e sigurisë.

9.1.1 Përzgjedhja e materialeve

9.1.1.1 Materialet e përdorura në konstruksionin e pajisjeve dhe të sistemeve mbrojtëse duhet të marrin parasysh sforcimet e parashikuara funksionale që të mos shkaktojnë një shpërthim.

9.1.2.2 Brenda kufijve të kushteve të funksionimit të përcaktuara nga fabrikuesi, midis materialeve të përdorura dhe përbërësve të atmosferës potencialisht shpërthyes nuk duhet të lindë asnjë reaksion që mund të përkeqësojë mbrojtjen ndaj shpërthimit.

9.1.1.3 Materialet duhet të përzgjidhen të tilla që ndryshimet e parashikueshme në vetë karakteristikat e tyre dhe pajtueshmëria e tyre në kombinimin me materiale të tjera të përdorura, të mos çojnë në një ulje të mbrojtjes së ofruar, veçanërisht për sa i përket rezistencës ndaj korrozionit dhe asaj ndaj konsumit, përcjellshmërisë elektrike, fortësisë, rezistencës ndaj vjetërimit dhe efekteve prej ndryshimeve të temperaturës.

9.1.2 Projektimi dhe fabrikimi

9.1.2.1 Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të projektohen dhe fabrikohen duke pasur parasysh njohuritë teknologjike në lidhje me mbrojtjen ndaj shpërthimeve për të mundësuar funksionimin e tyre në mënyrë të sigurt për të gjithë afatin kohor të përdorimit të tyre.

9.1.2.2 Komponentet që montohen ose që përdoren si pjesë këmbimi në pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të projektohen dhe të fabrikohen në mënyrë të tillë që kur ato të instalohen në përputhje me instruksionet e fabrikuesit, të funksionojnë të sigurt sipas qëllimit të tyre të parashikuar për mbrojtjen ndaj shpërthimeve.

9.1.2.3 Konstruksionet e mbyllura dhe parandalimi i rrjedhjeve

Për pajisjet, të cilat mund të çlirojnë gaze ose pluhura të ndezshëm duhet të parashikohen, brenda mundësive, vetëm struktura të mbyllura.

Nëse pajisja përmban hapje ose bashkime jokompakte, ato duhet të projektohen në atë mënyrë që çlirimi i gazeve ose pluhurave të mos mund të provokojnë atmosferë shpërthyes jashtë pajisjes.

Vendet e mbushjes dhe të zbrazjes duhet të projektohen dhe të pajisen, sa të jetë e mundur, në mënyrë të tillë që të kufizojnë rrjedhjet e lëndëve të ndezshme gjatë mbushjes ose zbrazjes.

9.1.2.4 Depozitimet e pluhurave

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse që parashikohet të përdoren në vende të ekspozuara ndaj pluhurave, duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të mos provokojnë ndezjen e pluhurave që depozitohen në sipërfaqet e tyre.

Përgjithësisht depozitimet e pluhurave duhet të kufizohen sa të jetë e mundur. Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të jenë lehtësisht të pastrueshme.

Temperaturat në sipërfaqet e pjesëve të pajisjes duhet të mbahen ndjeshëm nën temperaturën e flakërimit të pluhurit që depozitohet.

Duhet të merret parasysh trashësia e depozitës së pluhurit, dhe nëse kërkohet, të merren masa për të kufizuar temperaturat, me qëllim që të shmangët akumulimi i nxehtësisë.

9.1.2.5 Mjete të tjera plotësuese mbrojtëse

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të cilat mund të jenë të ekspozuara ndaj disa tipeve të veçantë agjentësh të jashtëm, duhet të pajisen kur nevojitet me mjete plotësuese mbrojtëse.

Pajisjet duhet t'i përballojnë këta agjentë pa efekte shtesë në mbrojtjen ndaj shpërthimit.

9.1.2.6 Hapja e sigurt

Nëse pajisjet dhe sistemet mbrojtëse janë vendosur brenda një konteneri (të ngurtë apo fleksibël), pjesët e mbrojtjes ndaj shpërthimit duhet mundësuar hapja e këtyre kontainerëve nëpërmjet instrumenteve të veçantë ose mënyrave të tjera të përshtatshme mbrojtëse.

9.1.2.7 Mbrojtja ndaj rreziqeve të tjera

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë që:

a) të shmangin rrezikun e dëmtimeve fizike ose të dëmeve të tjera të cilat mund të shkaktohen nga kontakti i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë;

b) të garantojnë që të mos krijohen temperatura të tilla në sipërfaqet e pjesëve të kontaktit ose rrezatime, të cilat mund të shkaktojnë rreziqe;

c) të eliminohen rreziqe të natyrës joelektrike që njihen nga eksperiencia;

d) të garantohet se kushtet e parashikuara të mbingarkesës nuk do të provokojnë një situatë të rrezikshme.

Atje ku rreziqet e referuara në këtë paragraf, për pajisjet dhe sistemet mbrojtës, janë tërësisht apo pjesërisht të mbuluara nga rregulla të tjera teknike, ky rregull teknik nuk zbatohet ose ndërpritet së zbatuari për këto pajisje apo sisteme mbrojtëse, si dhe për këto rreziqe, kur fillon zbatimi i atyre rregullave teknike specifike.

9.1.2.8 Mbingarkimi i pajisjeve

Mbingarkimi i rrezikshëm i pajisjes duhet të parandalohet që në fazën e projektimit nëpërmjet mjeteve të integruara të matjeve, të komandimit e të rregullimit, të tilla si kufizues të rrymës, kufizues të temperaturës, çelësa diferencialë presioni, matës të prurjes së lëngjeve, rele kohe, monitorues të mbishpejtësisë dhe/ose tipe të ngjashëm aparatesh monitorimi.

9.1.2.9 Sistemet e mbyllura për mbajtjen e flakës

Nëse pjesët që mund të shkaktojnë ndezjen e një atmosfere shpërthyes vendosen në një vend të mbyllur, duhet të merren masa për të siguruar se vendi i mbyllur përballon presionin e formuar gjatë një shpërthimi të brendshëm të një përzierjeje shpërthyes dhe parandalon transmetimin e shpërthimit rreth vendit të mbyllur.

9.1.3 Burimet e mundshme të flakërimit (ndezjes)

9.1.3.1 Rreziqet që rrjedhin nga burime të ndryshme ndezëse.

Duhet të shmangen burime të mundshme ndezjeje, si: shkëndija, flakë, harqe elektrike, temperatura sipërfaqësore të larta, çlirim energjie akustike, rrezatime optike, valë elektromagnetike ose burime të tjera.

9.1.3.2 Rreziqet që rrjedhin nga ngarkesat elektrostатike

Duhet të parandalohen, nëpërmjet masave të përshtatshme, ngarkesat elektrostатike që mund të provokojnë shkarkime të rrezikshme.

9.1.3.3 Rreziqet që rrjedhin nga rrymat elektrike parazitare dhe nga rrjedhjet

Duhet të parandalohet që në përcjellësit e pajisjeve të krijohen rryma elektrike parazitare apo rrjedhje të tilla që sjellin p.sh., një korrozion të rrezikshëm, një tejnxehje të sipërfaqeve apo shkëndija që

janë në gjendje të provokojnë një ndezje.

9.1.3.4 Rreziqet që rrjedhin nga tejnxehja

Që në fazën e projektimit, duhet parandaluar, sa të jetë e mundur, tejnxehja e shkaktuar nga fërkimi ose nga përplasjet që mund të ndodhin p.sh. ndërmjet pjesëve në kontakt, në lëvizje relative përkundrejt njëri-tjetrit ose nëpërmjet futjes në to të trupave të huaj

9.1.3.5 Rreziqet që rrjedhin nga fenomenet e balancimit të presioneve

Proceset e balancimit të presioneve duhet të rregullohen që në periudhën e projektimit, nëpërmjet përdorimit të mjeteve të përshtatshme të integruara për matjen, kontrollin apo rregullimin në mënyrë që të mos provokohen valë goditëse apo fryrje që mund të shkaktojnë ndezje.

9.1.4 Rreziqet që rrjedhin nga efekte të jashtme

9.1.4.1 Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të projektohen ose të fabrikohen në mënyrë të tillë që të jenë në gjendje ta kryejnë funksionin e tyre të parashikuar me siguri të plotë duke marrë parasysh kufijtë e kushteve të funksionimit të përcaktuara nga fabrikuesi, madje dhe gjatë ndryshimit të kushteve mjedisore, të pranisë së tensioneve elektrike parazitare, të lagështisë, të vibrimeve, të kontaminimit apo efekteve të tjera të jashtme.

9.1.4.2 Pjesët e përdorura të pajisjet duhet të jenë të përshtatshme ndaj ngarkesave të parashikuara mekanike dhe termike dhe t'u rezistojnë veprimit agresiv të substancave ekzistuese ose të parashikuara.

9.1.5 Kërkesa për mjetet e sigurimit teknik

9.1.5.1 Mjetet e sigurimit teknik duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur nga çdo mjet matës ose kontrolli i kërkuar për ushtrimin e funksionit.

Defekti në një mjet të sigurimit teknik duhet të zbulohet sa më shpejt të jetë e mundur me mjete teknike të përshtatshme që garantojnë se mundësitë për të ndodhur situata të rrezikshme janë shumë të vogla.

Në përgjithësi, për qarqet elektrike zbatohet parimi i sigurisë ndaj defektit.

Në përgjithësi, çelësat e sigurisë duhet të aktivizojnë drejtpërsëdrejti organet e kontrollit pa komanda të ndërmjetme të programit (software).

9.1.5.2 Ku është e mundur, pajisjet dhe/ose sistemet mbrojtëse duhet të jenë të siguruara, edhe në rast të një defekti në një mjet sigurimi teknik.

9.1.5.3 Kontrollat e ndalimit emergjent të mjeteve të sigurimit teknik duhet që mundësisht të pajisen me një sistem bllokimi që pengon nisjen e paqëllimshme të funksionimit. Një komandë e re nisjeje e dhënë duhet të aktivizojë funksionimin normal vetëm pasi sistemi i bllokimit që pengon nisjen e paqëllimshme të jetë kthyer qëllimisht në pozicionin e tij të mëparshëm.

9.1.5.4 Mjetet e sinjalizimit dhe të kontrollit

Ku përdoren mjete sinjalizimi dhe kontrolli, ato duhet të projektohen në përputhje me parimet ergonomike, me qëllim që të arrihet niveli më i lartë i mundshëm i funksionimit të sigurt për sa i përket rrezikut të shpërthimit.

9.1.5.5 Kërkesat për mjetet me funksion matës, të parashikuara për mbrojtjen ndaj shpërthimit.

Mjetet me funksion matës, për sa u përket pajisjeve që përdoren në atmosfera potencialisht shpërthyes, duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar konform kërkesave të parashikuara të funksionimit dhe kushteve të veçanta të përdorimit.

9.1.5.6 Kur nevojitet, të mundësohet kontrolli i saktësisë së leximit dhe i aftësisë funksionale të mjetit me funksion matës.

9.1.5.7 Projektimi i mjetit me funksion matës duhet të marrë parasysh një koeficient sigurie që të garantojë që burimi i alarmit të jetë i vendosur mjaftueshëm larg kufijve të shpërthimit dhe/ose ndezjes së atmosferës që analizohet, sidomos duke marrë parasysh kushtet e punës së impiantit dhe gabimet e mundshme të sistemeve matëse.

9.1.5.8 Rreziqet që rrjedhin nga programimi (software)

Në projektimin e pajisjeve e sistemeve të mbrojtjes dhe të mjeteve të sigurimit teknik të kontrolluara nëpërmjet programeve (software), duhet të merren parasysh në mënyrë të veçantë risqet që rrjedhin nga anomalitë e mundshme të programeve.

9.1.6 Integrimi i kërkesave të sigurisë në lidhje me sistemin

9.1.6.1 Pajisjeve dhe sistemeve të mbrojtjes të instaluar në procese automatike që shmangen nga kushtet e parashikuara të punës duhet t'u mundësohet kalimi në kontroll manual për çaktivizimin e tyre, për sa kohë që nuk kompromentohen kushtet e përgjithshme të sigurisë.

9.1.6.2 Kur aktivizohet sistemi i ndalimit emergjent, energjia e akumuluar duhet të shpërndahet sa më shpejt dhe në mënyrën më të sigurt të mundshme, ose të veçohet që të mos përbëjë më një rrezik.

Kjo nuk zbatohet për energjinë e akumuluar me metoda elektrokimike

9.1.6.3 Rreziqet që rrjedhin nga ndërprerja e energjisë elektrike

Pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes, në të cilat ndërprerja e energjisë elektrike mund të shkaktojë përkeqësim të situatës së riskut, duhet të mbahen në kushte pune të sigurta pavarësisht pjesës tjetër të impiantit.

9.1.6.4 Rreziqet që rrjedhin nga lidhjet

Pajisjet dhe sistemet mbrojtëse duhet të pajisen me kablllo elektrike dhe hyrje të përshtatshme të përcjellësve.

Kur pajisjet dhe sistemet mbrojtëse janë parashikuar të përdoren në kombinim me pajisje dhe sisteme të tjera mbrojtëse, ndërfaqet duhet të jenë të siguruara.

9.1.6.5 Vendosja e mjeteve paralajmëruese si pjesë integrale e pajisjes

Atje ku pajisjet ose sistemet mbrojtëse pajisen me mjete zbulimi ose alarmi për mbikëqyrjen e krijimit të një atmosfere shpërthyesë, duhet të jepen instruksionet e nevojshme për vendosjen e këtyre mjeteve në vende të përshtatshme.

9.2 Kërkesa të tjera në lidhje me pajisjen

9.2.0 Kërkesat e zbatueshme në pajisjet e kategorisë M të grupit I të pajisjeve

9.2.0.1 Kërkesat e zbatueshme ndaj pajisjeve të kategorisë M1 të grupit I të pajisjeve.

9.2.0.1.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe fabrikohen në mënyrë të tillë që burimet e ndezjes të mos bëhen aktive, madje as në rastin e anomalive të rralla të pajisjes.

Pajisjet duhet të pajisen me mjete mbrojtëse të tilla që:

a) në rastin e dëmtimit të një mjeti mbrojtës, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e kërkuar të mbrojtjes, ose

b) në rastin kur ndodhin dy defekte në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, të sigurohet niveli i kërkuar i mbrojtjes.

Kur është e nevojshme, këto pajisje duhet të pajisen me mjete të tjera të veçanta të mbrojtjes.

Ato duhet të vazhdojnë të jenë funksionale në prani të një atmosfere shpërthyesë.

9.2.0.1.2 Kur është e nevojshme, pajisja duhet të konstruktoret që pluhurat të mos depërtojnë në të.

9.2.0.1.3 Temperaturat në sipërfaqet e pjesëve të pajisjes duhet të mbahen qartësisht poshtë temperaturës së parashikuar të ndezjes së përzierjeve ajër/pluhura me qëllim që të parandalohet ndezja e pluhurit të mbetur pezull në ajër.

9.2.0.1.4 Pajisjet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që hapja e pjesëve të pajisjeve, që mund të jenë burime ndezjeje, të mundësohet vetëm në kushte të çaktivizimit/mungesës së energjisë ose në kushte të plota sigurie. Kur është i pamundur çaktivizimi i pajisjes, fabrikuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesët e hapshme të saj.

Nëse nevojitet, pajisjet duhet të pajisen me sisteme rele shtesë të përshtatshme.

9.2.0.2 Kërkesat e zbatueshme në pajisjet e kategorisë M2 të grupit I të pajisjeve

9.2.0.2.1 Pajisjet duhet të jenë të pajisura me mjete mbrojtëse të cilat sigurojnë se burimet e ndezjes nuk bëhen aktive gjatë punës normale, madje as edhe në kushte shumë më të rënda pune, veçanërisht nga ato që lindin gjatë një shfrytëzimi të ashpër të pajisjes dhe ndryshimit të vazhdueshëm të kushteve mjedisore.

Në prani të atmosferave shpërthyesë, për këto pajisje duhet të jetë parashikuar ndërprerja e ushqimit me energji.

9.2.0.2.2 Pajisjet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që hapja e pjesëve të pajisjeve, që mund të jenë burime ndezjeje, të mundësohet vetëm në kushte të çaktivizimit/mungesës së energjisë ose nëpërmjet sistemeve rele të përshtatshme. Kur është i pamundur çaktivizimi i pajisjes, fabrikuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesët e hapshme të saj.

9.2.0.2.3 Kërkesat e lidhura me rreziqet e shpërthimit që rrjedhin nga pluhurat, të zbatueshme për kategorinë M1 të pajisjeve, janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe për kategorinë M2.

9.2.1 Kërkesat e zbatueshme në pajisjet e kategorisë 1 të grupit II të pajisjeve

9.2.1.1 Atmosfera shpërthyesë të shkaktuara nga prania e gazeve, avujve ose tymrave

9.2.1.1.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe fabrikohen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndezja e përzierjeve ajër/pluhura, madje edhe në rastin e anomalive të rralla në punën e pajisjes.

Pajisjet duhet të pajisen me mjete mbrojtëse të tilla që:

a) në rastin e dëmtimit të një mjeti mbrojtës, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e kërkuar të mbrojtjes; ose

b) në rastin kur ndodhin dy defekte në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, të sigurohet niveli i

kërkuar i mbrojtjes.

9.2.1.1.2 Për pajisjet me sipërfaqe që mund të tejnxeohen duhet të merren masa për të siguruar se nuk tejkalohen temperaturat maksimale të përcaktuara për sipërfaqet, madje as në kushte shumë me të përshtatshme.

Gjithashtu duhet të merren parasysh rritjet e temperaturës për shkak të akumulimeve graduale të nxehtësisë dhe reaksioneve kimike.

9.2.1.1.3 Pajisjet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që hapja e pjesëve të pajisjeve, që mund të jenë burime ndezjeje, të mundësohet vetëm në kushte të çaktivizimit/mungesës së energjisë ose në kushte të plota sigurie. Kur është i pamundur çaktivizimi i pajisjes, fabrikuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesët e hapshme të saj.

Nëse nevojitet, pajisjet duhet të pajisen me sisteme rele shtesë të përshtatshme.

9.2.1.2 Atmosferat shpërthyesë të shkaktuara nga prania e përzierjeve ajër/pluhura

9.2.1.2.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe fabrikohen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndezja e përzierjeve ajër/pluhura, madje edhe në rastin e anomalive të rralla në punën e pajisjes.

Pajisjet duhet të pajisen me mjete mbrojtëse, të tilla që:

a) në rastin e dëmtimit të një mjeti mbrojtës, të paktën një mjet i dytë i pavarur siguron nivelin e kërkuar të mbrojtjes, ose

b) në rastin kur ndodhin dy defekte në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, të sigurohet niveli i kërkuar i mbrojtjes.

9.2.1.2.2 Kur është e nevojshme, pajisjet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që pluhurat të mund të hyjnë ose të dalin nga pajisja vetëm në pikat e veçanta të projektuara për këtë qëllim.

Kjo kërkesë duhet të plotësohet gjithashtu edhe për hyrjet e kabllave elektrike dhe elementet lidhëse.

9.2.1.2.3 Temperaturat në sipërfaqet e pjesëve të pajisjes duhet të mbahen ndjeshëm nën temperaturën e ndezjes të parashikuar për përzierjet ajër/pluhura, me qëllim që të parandalohet ndezja e pluhurave të mbetur pezull në ajër.

9.2.1.2.4 Kërkesat që referohen në pikën 9.2.1.1.3 lidhur me sigurinë mbi hapjen e pjesëve të pajisjes janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë rast.

9.2.2 Kërkesat e zbatueshme për kategorinë 2 të grupit II të pajisjeve

9.2.2.1 Atmosfera shpërthyesë të shkaktuara nga prania e gazeve, avujve ose tymrave

9.2.2.1.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe fabrikohen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndezja e përzierjeve ajër/pluhura, madje edhe në rastin e anomalive të herëpashershme apo të defekteve, në punën e pajisjes, të cilat normalisht duhet të merren parasysh.

9.2.2.1.2 Pjesët e pajisjeve duhet të projektohen dhe të fabrikohen në mënyrë të tillë që të mos tejkalohen temperaturat e përcaktuara për sipërfaqet e tyre, madje edhe në rastin e rreziqeve të lindura nga situata jonormale të parashikuara nga fabrikuesi.

9.2.2.1.3 Pajisjet duhet të projektohen në mënyrë të tillë që hapja e pjesëve të pajisjeve, që mund të jenë burime ndezjeje, të mundësohet vetëm në kushte të çaktivizimit/mungesës së energjisë ose nëpërmjet sistemeve rele të përshtatshme. Kur është i pamundur çaktivizimi i pajisjes, fabrikuesi duhet të vendosë një etiketë paralajmëruese në pjesët e hapshme të saj.

9.2.2.2 Atmosferat shpërthyesë të shkaktuara nga prania e përzierjeve ajër/pluhura.

9.2.2.2.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe fabrikohen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndezja e përzierjeve ajër/pluhura, madje edhe në rastin e anomalive të herëpashershme apo të defekteve, në punën e pajisjes, të cilat normalisht duhet të merren parasysh.

9.2.2.2.2 Kërkesat që referohen në pikën 9.2.1.2.3 lidhur me temperaturat në sipërfaqe, janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë rast.

9.2.2.3 Kërkesat që referohen në pikën 9.2.1.2.2, lidhur me mbrojtjen nga pluhurat, janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë rast.

9.2.2.2.4 Kërkesat që referohen në pikën 9.2.1.3, lidhur me sigurinë ndaj hapjes së pjesëve të pajisjes, janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë rast.

9.2.3 Kërkesat e zbatueshme për kategorinë 3 të grupit II të pajisjeve.

9.2.3.1 Atmosfera shpërthyesë të shkaktuara nga prania e gazeve, avujve ose tymrave.

9.2.3.1.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe të fabrikohen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndezja e burimeve të parashikuara, gjatë punës normale të pajisjes.

9.2.3.1.2 Temperaturat në sipërfaqe nuk duhet të kalojnë temperaturat maksimale të përcaktuara në kushte pune të parashikuara. Temperatura më të larta, në rrethana të jashtëzakonshme, mund të lejohen

vetëm nëse fabrikuesi përshtat masa të tjera të veçanta mbrojtëse.

9.2.3.2 Atmosferat shpërthyesë të shkaktuara nga prania e përzierjeve ajër/pluhur

9.2.3.2.1 Pajisjet duhet të projektohen dhe të fabrikohen në mënyrë të tillë që të parandalohet ndezja e përzierjeve ajër/pluhur prej burimeve të parashikuara të ndezjes, gjatë punës normale të pajisjes.

9.2.3.2.2 Kërkesat që referohen në pikën 9.2.1.2.3, lidhur me temperaturat në sipërfaqe, janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe në këtë rast.

9.2.3.2.3 Pajisjet, duke përfshirë hyrjet e kabllave elektrike dhe elementet lidhëse, duhet të fabrikohen në mënyrë të tillë që, duke marrë parasysh madhësinë e grimcave të tyre, pluhurat të mos mund të krijojnë përzierje potencialisht shpërthyesë me ajrin dhe as të mund të formohen depozitime të rrezikshme pluhuri brenda pajisjes.

9.3. Kërkesa plotësuese në lidhje me sistemet mbrojtëse

9.3.0 Kërkesa të përgjithshme

9.3.0.1 Sistemet mbrojtëse duhet të dimensionohen në atë mënyrë që të zbusin efektet e një shpërthimi deri në një nivel të mjaftueshëm sigurie.

9.3.0.2 Sistemet mbrojtëse duhet të projektohen dhe të instalohen në atë mënyrë që të parandalohet efekti zinxhir nga transmetimi i rrezikshëm i shpërthimeve, apo i rrezatimit të nxehtësisë, duke bërë që shpërthimet e vogla fillestare të shndërrohen në plasje masive.

9.3.0.3 Në rastin e ndërprerjes së ushqimit me energji, sistemet mbrojtëse duhet të qëndrojnë në gjendje pune edhe për një periudhë të caktuar, të mjaftueshme për të shmangur një situatë të rrezikshme.

9.3.0.4 Sistemet mbrojtëse nuk duhet të paraqesin anomali në punën e tyre për shkak të ndërhyrjeve nga jashtë.

9.3.1 Studimi dhe projektimi

9.3.1.1 Karakteristikat e materialeve

Presioni dhe temperatura maksimale e referimit për studimin e karakteristikave të materialeve janë presioni i pritshëm në rast ndodhje të një shpërthimi në kushtet e tejskajshme të shfrytëzimit dhe ndikimi i nxehtësisë së provokuar nga flaka e parashikuar.

9.3.1.2 Sistemet mbrojtëse të projektuara që t'u rezistojnë ose të kontrollojnë shpërthimet, duhet të jenë në gjendje të përballojnë valën goditëse të krijuar pa humbur integritetin e sistemit.

9.3.1.3 Pajisjet ndihmëse të lidhura me sistemet mbrojtëse duhet të jenë në gjendje të përballojnë presionin maksimal të pritshëm të shpërthimit pa humbur aftësitë e tyre të funksionimit.

9.3.1.4 Në fazën e studimit të sistemeve mbrojtëse, duhet të merren parasysh edhe pasojat që rrjedhin nga presioni i ushtruar mbi atrecaturat anësore dhe mbi tubacionet lidhëse.

9.3.1.5 Sistemet e shkarkimit të presionit

Nëse pritet që ngarkesat mbi sistemet mbrojtëse do të tejkalojnë qëndrueshmërinë strukturore të tyre, projekti duhet të parashikojë valvola sigurie për shkarkimin e mbipresionit, duke u siguruar që ky shkarkim nuk rrezikon personelin në afërsi.

9.3.1.6 Sistemet e ndrydhjes së shpërthimit

Sistemet e ndrydhjes së shpërthimeve duhet të studiohen dhe të projektohen në atë mënyrë që, në raste incidentesh, ata ta vendosin nën kontroll që në fazën e parë shpërthimin dhe të kundërveprojnë në mënyrën më optimale, duke u bazuar në rritjen me shpejtësinë më të lartë të presionit, si dhe në presionin maksimal të shpërthimit.

9.3.1.7 Sistemet e shkëputjes

Sistemet e parashikuara për të shkëputur pajisje të caktuara në fazën fillestare të shpërthimit, me mjete të përshtatshme dhe brenda një kohe shumë të shkurtër, duhet të studiohen dhe të projektohen në mënyrë të tillë që t'i bëjnë ballë transmetimit të flakëve të brendshme dhe ta ruajnë qëndrueshmërinë e tyre mekanike në kushte pune.

9.3.1.8 Sistemet mbrojtëse duhet të jenë të integruara brenda një qarku me një portë të përshtatshme alarmi, të tillë që, nëse është e nevojshme, të mundësohet një ndërprerje e hyrje-daljes së produkteve dhe të shkëputen ato pjesë të pajisjes që nuk mund të funksionojnë më në mënyrë të sigurt.

10. Moduli: Shqyrtimi "CE" i tipit

10.1 Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës, me të cilën një organ i autorizuar/organizëm evropian përcakton dhe deklaron se një mostër përfaqësuese e një prodhimi plotëson kushtet përkatëse të zbatueshme të këtij rregulli teknik.

10.2 Aplikimi për shqyrtimin "CE" të tipit paraqitet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar në një organ të autorizuar/organizëm evropian të zgjedhur nga vetë ai.

Aplikimi përmban:

a) emrin dhe adresën e fabrikuesit dhe, nëse aplikimi është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, vendoset emri dhe adresa e tij;

b) Një deklaram me shkrim se i njëjti aplikim nuk është paraqitur në një tjetër organ të autorizuar/organizëm europian;

c) Dokumentacionin teknik, siç është përshkruar në pikën 10.3.

Aplikanti vë në dispozicion të organit të autorizuar/organizmit europian një mostër përfaqësuese të prodhimit të dhënë, që më poshtë quhet “tipi”. Organi i autorizuar/organizmi europian mund të kërkojë mostra të tjera nëse është e nevojshme për kryerjen e programit të provave.

10.3 Dokumentacioni teknik mundëson vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat e rregullit teknik. Për një vlerësim të tillë, ai duhet të mbulojë në një masë të mjaftueshme projektimin, prodhimin dhe funksionimin e produktit dhe përmban:

a) një përshkrim të përgjithshëm të tipit;

b) vizatimet e projektit, të prodhimit, si dhe skicat e komponentëve, nënnyjeve, qarqeve etj.;

c) përshkrimet dhe sqarimet e nevojshme për kuptimin e vizatimeve dhe skicave, si dhe funksionimin e produktit;

d) një listë të standardeve të harmonizuara, të zbatuara plotësisht apo pjesërisht, dhe përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesat thelbësore të rregullit teknik kur standardet e harmonizuara nuk janë zbatuar;

e) rezultatet e llogaritjeve të bëra në projektim, shqyrtimet e bëra etj.;

f) raportet e provave të kryera.

10.4 Organi i autorizuar/organizmi europian:

a) shqyrton dokumentacionin teknik, verifikon nëse tipi është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik dhe identifikon elementet të cilat janë projektuar në përputhje me kërkesat përkatëse të standardeve të harmonizuara, si edhe elementet të cilët janë projektuar pa zbatuar kërkesat përkatëse të këtyre standardeve të harmonizuara;

b) kryen ose detyron kryerjen e shqyrtimeve përkatëse dhe provave të nevojshme për të verifikuar nëse zgjidhjet e përshtatura nga fabrikuesi plotësojnë kërkesat thelbësore të rregullit teknik, atje ku nuk janë zbatuar standardet e harmonizuara.

c) kryen ose detyron kryerjen e shqyrtimeve përkatëse dhe provave të nevojshme, për të verifikuar nëse fabrikuesi që ka zgjedhur të zbatojë standardet përkatëse, i ka zbatuar ato në praktikë.

d) bie dakord me aplikantin për vendin ku do të kryhen shqyrtimet dhe provat e nevojshme.

10.5 Kur tipi i plotëson kërkesat e rregullit teknik, organi i autorizuar/organizmi europian i lëshon aplikantit një certifikatë të shqyrtimit “CE” të tipit. Certifikata përmban emrin dhe adresën e fabrikuesit, konkluzionet e shqyrtimit dhe të dhënat e nevojshme për identifikimin e tipit të aprovuar.

Një listë të pjesëve përkatëse të dokumentacionit teknik i aneksohet certifikatës dhe një kopje mbahet nga organi i autorizuar/organizmi europian.

Nëse fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij të autorizuar i refuzohet një certifikim i tipit, organi i autorizuar/organizmi europian jep arsyet e detajuara për këtë refuzim. Një procedurë apelimi parashikohet në këtë rast.

10.6 Aplikanti informon organin e autorizuar/organizmin europian, cili mban dokumentacionin teknik në lidhje me certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit, për të gjitha modifikimet e pajisjes ose sistemit të mbrojtjes të aprovuar, për të cilat duhet të marrë aprovim tjetër, kur ndryshime të tilla mund të ndikojnë përputhueshmërinë me kërkesat thelbësore ose me kushtet e përshkruara, për përdorimin e produktit. Aprovimi tjetër jepet në formën e një shtesë në certifikatën origjinale “CE” të shqyrtimit të tipit.

10.7 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian u komunikon organizmave të tjerë informacionin përkatës në lidhje me certifikatat “CE” të shqyrtimit të tipit, si dhe shtesat e lëshuara apo heqjen e tyre.

10.8 Organet e tjera të autorizuar/organizma europianë mund të marrin kopje të certifikatave CE të shqyrtimit të tipit dhe ose shtesat mbi to. Aneksat e certifikatave CE të shqyrtimit të tipit mbahen në dispozicion të organeve të tjera të autorizuar/organizëm europian.

10.9 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban së bashku me dokumentacionin teknik edhe kopjet e certifikatave “CE” të shqyrtimit të tipit dhe shtesat e tyre për një periudhë së paku 10 vjet që nga prodhimi i fundit i pajisjes ose sistemit mbrojtës.

Kur as fabrikuesi dhe as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk është në Shqipëri, detyrimi për mbajtjen disponibël të dokumentacionit teknik është nën përgjegjësinë e personit që e vendos këtë produkt në treg.

11. Moduli: Sigurimi i cilësisë së prodhimit

11.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi që plotëson detyrimet e pikës

11.2 siguron dhe deklaron se produktet përkatëse, janë në përshtatshmëri me tipin e përshkruar në

certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit dhe plotëson kërkesat e rregullit teknik që zbatohet mbi to. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin “CE” në çdo pjesë të pajisjes dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit. Markimi “CE” shoqërohet nga numri i identifikimit i organit të autorizuar/organizmi evropian përgjegjës për monitorimin “CE”, siç është përcaktuar në pikën 11.4.

11.2 Fabrikuesi operon një sistem të aprovuar të cilësisë për prodhimin, inspektimin përfundimtar të pajisjes dhe provave, siç referohet në seksionin 11.3 dhe është subjekt i monitorimit, siç referohet në seksionin 11.4.

11.3. Sistemi i cilësisë

11.3.1 Fabrikuesi paraqet një aplikim për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për pajisjen në fjalë, pranë një organi të autorizuar/organizmi evropian të zgjedhur prej tij.

Aplikimi përfshin:

a) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e produktit në fjalë;

b) dokumentacionin e lidhur me sistemin e cilësisë;

c) dokumentacionin teknik mbi tipin e aprovuar dhe një kopje të certifikatës “CE” të shqyrtimit të tipit;

11.3.2 Sistemi i cilësisë siguron përputhjen e pajisjes me tipin e përshkruar në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat e rregullit teknik që zbatohen mbi të.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe kushtet e përshtatura nga fabrikuesi dokumentohen në një mënyrë sistematike dhe të rregullt, në formë të shkruar të politikave, të procedurave dhe të instruksioneve. Dokumentacioni i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim uniform të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm të:

a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësitë dhe kompetencat e menaxhimit të lidhura me cilësinë e pajisjes;

b) prodhimit, kontrollit të cilësisë dhe teknikave të sigurimit të cilësisë, proceseve dhe veprimeve sistematike që janë përdorur;

c) shqyrtimeve dhe provave që kryhen përpara, gjatë dhe pas prodhimit dhe frekuencat në të cilat ato kryhen;

d) regjistrave të cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi provat, raporte mbi kualifikimet e personelit të përfshirë në to etj.;

e) mjeteve për të monitoruar arritjet e cilësisë së kërkuar të pajisjes dhe operimin efektiv të sistemit të cilësisë.

11.3.3 Organi i autorizuar/organizmi evropian vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e referuara në seksionin 11.3.2. Ai prezumon konformitetin me këto kërkesa në lidhje me sistemet e cilësisë që implementojnë standardet përkatëse të harmonizuara. Ekipi i auditimit ka të paktën një anëtar me eksperiencë në vlerësimin e teknologjisë së lidhur me pajisjen. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë inspektimi në ambientet e fabrikuesit. Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e verifikimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

11.3.4 Fabrikuesi merr përsipër plotësimin e detyrimeve të dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe mbështet sistemin që të mbetet i përshtatshëm dhe eficient.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar informon organin e autorizuar/organizmin evropian për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e aprovuar të cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi evropian vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i cilësisë i plotëson akoma kërkesat e referuara në seksionin 11.3.2 apo kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai njofton fabrikuesin mbi vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

11.4 Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit evropian.

11.4.1 Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se fabrikuesi i përmbush si duhet detyrimet e dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

11.4.2 Fabrikuesi, për qëllime inspektimi, i lejon organit të autorizuar/organizmi evropian të hyjë në vendet e prodhimit, inspektimit, testimit dhe magazinimit dhe i siguron atij të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;

b) regjistrat e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi në formë teksti, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimet e personelit të përfshirë, etj.;

11.4.3 Organi i autorizuar/organizmi evropian kryen periodikisht auditime për t’u siguruar se

fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i dërgon fabrikuesit një raport auditimi.

11.4.4 Organi i autorizuar/organizmi europian gjithashtu mund të bëjë vizita të palajmëruara tek fabrikuesi. Gjatë vizitave të tilla organi i autorizuar/organizmi europian mund të kryejë prova ose të detyrojë kryerjen e provave për të verifikuar nëse sistemi i cilësisë funksionon korrektësisht. Organi i autorizuar/organizmi europian i jep fabrikuesit raportin e vizitës dhe, nëse ka kryer prova, edhe raportin e provave.

11.5 Fabrikuesi, për një periudhë 10 vjet nga prodhimi i fundit i pajisjes, mban në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut:

- a) dokumentacionin, siç referohet në fillimin e seksionit 11.3.1;
- b) ndryshimet e referuara në paragrafin e dytë të seksionit 11.3.4;
- c) vendimet dhe raportet e organit të autorizuar/organizmit europian, siç referohen në seksionin 11.3.4, paragrafi i fundit, seksionin 11.4.3 dhe seksionin 11.4.4.

11.6 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian informon organizmat e tjerë mbi informacionin përkatës të lidhur me aprovimet e sistemit të cilësisë të lëshuara ose të hequra.

12. Moduli: Verifikimi i produktit

12.1. Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës një fabrikues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar sigurohet dhe deklaron që pajisjet, subjekt i kërkesave të pikës 12.3 janë në konformitet me tipin, siç përshkruhet në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit dhe plotëson kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

12.2 Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se procesi i prodhimit garanton konformitetin e pajisjes me tipin e përshkruar në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat e rregullit teknik që zbatohet mbi to. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij vendos markimin “CE” në çdo copë pajisjeje dhe harton një deklaratë të konformitetit.

12.3 Organi i autorizuar/organizmi europian kryen shqyrtimet dhe provat përkatëse që të verifikojë konformitetin e pajisjes, sistemit mbrojtës apo mjetit, të referuar në pikën 1.2, me kërkesat përkatëse të rregullit teknik, duke shqyrtuar dhe testuar çdo produkt siç përcaktohet në pikën 12.4.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban një kopje të deklaratës së konformitetit për një periudhë së paku 10 vjet pas prodhimit të copës së fundit të pajisjes.

12.4 Verifikimi me shqyrtim dhe testim të çdo cope pajisjeje

12.4.1 Të gjitha pajisjet shqyrtohen në mënyrë individuale dhe duhet t’u nënshtrohen provave siç përcaktohet në standardin/et përkatës të harmonizuar, ose provave të barazvlefshme me to, me qëllim që të verifikohet konformiteti i tyre me tipin e përshkruar në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit dhe me kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

12.4.2 Organi i autorizuar/organizmi europian vendos ose detyron vendosjen e numrit të identifikimit në çdo copë pajisjeje të aprovuar dhe harton me shkrim një certifikatë për konformitetin lidhur me provat e kryera.

12.4.3 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron se ai është në gjendje t’i japë organit të autorizuar/organizmi europian, nëse kërkohet, certifikatat e konformitetit.

13. Moduli: Konformiteti ndaj tipit

13.1 Ky modul përshkruan atë pjesë të procedurës me anë të së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron dhe deklaron se pajisja në fjalë është në konformitet me tipin, siç është përshkruar në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit, dhe plotëson kërkesat e rregullit teknik të zbatueshme për të.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i autorizuar i tij vendos markimin “CE” në çdo copë të pajisjes dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

13.2 Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar se procesi i prodhimit siguron përputhjen e pajisjes ose sistemit mbrojtës së prodhuar me tipin, siç përshkruhet në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit, si dhe me kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

13.3 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban një kopje të deklaratës së konformitetit për një periudhë të paktën 10-vjeçare pas prodhimit të copës së fundit të pajisjes.

Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk mbart detyrimin e mbajtjes së dokumentacionit përkatës teknik, kjo është përgjegjësi e personit që vendos pajisjen apo sistemin mbrojtës në treg.

Për çdo copë të pajisjes së prodhuar, testimet e lidhura me aspektet e mbrojtjes antishpërthyesë të produktit kryhen nga fabrikuesi ose në emër të tij. Testimet kryhen nën përgjegjësinë e një organi të autorizuar/organizmi europian të zgjedhur nga fabrikuesi.

Nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmi europian, fabrikuesi vendos numrin e identifikimit të dhënë gjatë procesit të prodhimit.

14. Moduli: Sigurimi i cilësisë së produktit

14.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi që plotëson detyrimet e pikës 4.2 sigurohet dhe deklaron se pajisja është në konformitet me tipin e përshkruar në certifikatën “CE” të shqyrtimit të tipit. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin “CE” për çdo produkt dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit. Markimi “CE” shoqërohet nga numri i identifikimit i organit të autorizuar/organizmi evropian përgjegjës për mbikëqyrjen, siç përcaktohet në pikën 14.4.

14.2 Fabrikuesi operon me një sistem të aprovuar cilësie për inspektimin përfundimtar dhe testimin e pajisjes, siç përcaktohet në pikën 14.3, dhe është subjekt i mbikëqyrjes siç përcaktohet në pikën 14.4.

14.3 Sistemi i cilësisë

14.3.1 Fabrikuesi paraqet një aplikim për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë për pajisjen dhe sistemet mbrojtëse në një organ të autorizuar/organizëm evropian, të zgjedhur prej tij.

Aplikimi përmban:

- a) të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e produktit;
- b) dokumentacionin lidhur me sistemin e cilësisë;
- c) dokumentacionin teknik mbi tipin e aprovuar dhe një kopje të certifikatës “CE” të shqyrtimit të tipit.

14.3.2 Mbështetur në sistemin e cilësisë, çdo copë e pajisjes shqyrtohet dhe testohet, siç përcaktohet në standardet përkatëse të harmonizuara ose kryhen teste të barazvlershme që të sigurohet konformiteti i saj me kërkesat përkatëse të rregullit teknik. Të gjitha elementet, kërkesat dhe kushtet e përshtatura nga fabrikuesi dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formë të shkruar, të politikave, procedurave dhe instruksioneve.

Ky dokumentacion i sistemit të cilësisë duhet të lejojë një interpretim uniform të programeve, planeve, manualeve dhe regjistrave të cilësisë.

Ai përmban veçanërisht një përshkrim të mjaftueshëm të:

- a) objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencave të menaxhimit të lidhura me cilësinë e produktit;
- b) shqyrtimeve dhe testeve të kryera mbas prodhimit;
- c) mjeteve të monitorimit për operimin efektiv të sistemit të cilësisë;
- d) regjistrave të cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna mbi testimet, raporte mbi kualifikimet e personelit të përfshirë në to, etj.

14.3.3 Organi i autorizuar/organizmi evropian vlerëson sistemin e cilësisë për të përcaktuar nëse ai plotëson kërkesat e referuara në pikën 14.3.2. Ai prezumon konformitetin me këto kërkesa në lidhje me sistemet e cilësisë që përcaktojnë standardet përkatëse të harmonizuara.

Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë si vlerësues në teknologjinë e produktit në fjalë. Procedura e vlerësimit përfshin një vizitë vlerësimi në ambientet e fabrikuesit.

Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

14.3.4 Fabrikuesi merr përsipër kryerjen e detyrimeve të dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë dhe e mirëmban atë në një mënyrë të përshtatshme dhe efçente.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar informon organin e autorizuar/organizmin evropian që ka aprovuar sistemin e cilësisë për çdo ndryshim të parashikuar në sistemin e cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi evropian vlerëson ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i modifikuar i cilësisë i plotëson akoma kërkesat e referuara në pikën 14.3.2 ose nëse kërkohet një rivlerësim i tij.

Ai i njofton fabrikuesit vendimin e tij. Njoftimi përmban konkluzionet e shqyrtimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

14.4 Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmi evropian

14.4.1 Mbikëqyrja ka si qëllim që të sigurojë se fabrikuesi përmbush siç duhet detyrimet e dala nga sistemi i aprovuar i cilësisë.

14.4.2 Për qëllime inspektimi, fabrikuesi lejon organin e autorizuar/organizëm evropian të hyjë në ambientet e inspektimit, testimit dhe magazinimit dhe i siguron të gjithë informacionin e nevojshëm, veçanërisht:

- a) dokumentacionin e sistemit të cilësisë;
- b) dokumentacionin teknik;
- c) regjistrat e cilësisë, të tilla si raporte inspektimi dhe të dhëna testi, të dhëna mbi kalibrimin, raporte mbi kualifikimet e personelit të përfshirë në to, etj.

14.4.3 Organi i autorizuar/organizmi evropian kryen periodikisht auditime për t’u siguruar që

fabrikuesi mirëmban dhe zbaton sistemin e cilësisë dhe i jep fabrikuesit raportin e auditit.

14.4.4 Organi i autorizuar/organizmi europian mund të bëjë gjithashtu vizita të palajmëruara tek fabrikuesi. Gjatë vizitave të tilla organi i autorizuar/organizmi europian mund të kryejë prova ose të detyrojë kryerjen e provave për të kontrolluar funksionimin e duhur të sistemit të cilësisë. Ai i jep fabrikuesit raportin e vizitës dhe, nëse ka kryer një provë, edhe raportin e saj.

14.5 Për një periudhë 10-vjeçare nga prodhimi i copës së fundit të pajisjes fabrikuesi mban në dispozicion të autoriteteve kombëtare:

- a) dokumentacionin, siç referohet në paragrafin e parë të pikës 14.3.1;
- b) ndryshimet e referuara në paragrafin e dytë të pikës 14.3.4;
- c) vendimet dhe raportet e organit të autorizuar/organizmit europian të referuara në paragrafin e fundit të pikës 14.3.4, pikën 14.4.3 dhe pikën 14.4.4.

14.6 Çdo organ i autorizuar/organizëm europian informon organizmat e tjerë mbi informacionin përkatës të lidhur me aprovimet e sistemit të cilësisë të lëshuara ose të hequra.

15. Moduli: Kontrolli i brendshëm i prodhimit

15.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar që kryen detyrimet e dhëna në pikën 15.2, sigurohet dhe deklaron se pajisja plotëson kërkesat e rregullit teknik të zbatueshme ndaj saj. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij autorizuar vendos markimin “CE” në çdo copë të pajisjes dhe harton me shkrim një deklaratë të konformitetit.

15.2 Fabrikuesi harton dokumentacionin teknik të përshkruar në pikën 15.3 dhe ai ose përfaqësuesi i tij i autorizuar e mban atë për qëllime inspektimi në dispozicion të autoriteteve përkatëse kombëtare për një periudhë së paku 10 vjet mbasi është prodhuar copa e fundit e pajisjes.

Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk ndodhen në Shqipëri, detyrimin për të mbajtur disponibël dokumentacionin teknik e ka personi që vendos pajisjen në treg.

15.3 Dokumentacioni teknik mundëson vlerësimin e konformitetit të pajisjes me kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

Për nevoja të një vlerësimi të tillë, ai mbulon projektimin, prodhimin dhe funksionimin e produktit. Ai përmban:

- a) një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes;
- b) projektin konceptual, vizatimet e prodhimit dhe skemat e komponentëve, nënnyjeve, qarqeve, etj;
- c) përshkrime dhe sqarime të nevojshme mbi kuptimin e këtyre skemave dhe vizatimeve, si dhe funksionimin e pajisjes;
- d) një listë të standardeve të zbatuar plotësisht apo pjesërisht dhe përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura që plotësojnë aspektet mbi sigurinë të rregullit teknik kur nuk janë zbatuar standardet;
- e) rezultatet llogaritjeve të bëra në projektim, kontrollet e kryera, etj.;
- f) raportet e provave të kryera.

15.4 Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij autorizuar mban bashkë me dokumentacionin teknik dhe një kopje të deklaratës së konformitetit.

15.5 Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar se procesi i prodhimit garanton përputhjen e pajisjes së prodhuar me dokumentacionin teknik të referuar në pikën 15.2 dhe me kërkesat e rregullit teknik të zbatueshme për këtë pajisje.

16. Moduli: Verifikimi i njësisë së produktit

16.1 Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi sigurohet dhe deklaron se pajisja ose sistemi mbrojtës për të cilën është lëshuar një certifikatë, siç referohet në pikën 16.2, përputhet me kërkesat e rregullit teknik të zbatueshme ndaj saj. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin “CE” në pajisje ose në sistemin mbrojtës dhe harton një deklaratë konformiteti.

16.2 Organi i autorizuar/organizmi europian shqyrton pajisjen ose sistemin mbrojtës në mënyrë individuale dhe kryen provat përkatëse, siç është dhënë në standardin/et përkatës, ose prova të barazvlershme me to, për të siguruar konformitetin me kërkesat përkatëse të rregullit teknik.

Organi i autorizuar/organizmi europian vendos ose detyron vendosjen e numrit të identifikimit mbi pajisjen ose sistemin mbrojtës të aprovuar dhe harton një certifikatë konformiteti të lidhur me provat e kryera.

16.3 Qëllimi i dokumentacionit teknik është të mundësojë vlerësimin e konformitetit të pajisjes ose sistemit mbrojtës me kërkesat e rregullit teknik, si dhe të jetë i qartë projekti, prodhimi dhe funksionimi i tyre.


Dokumentacioni përmban:

- a) një përshkrim të përgjithshëm të produktit;
- b) projektin konceptual dhe vizatimet e prodhimit, skicat e komponentëve, nënmontimet, qarqet etj;
- c) përshkrimet dhe shpjegimet e nevojshme mbi kuptimin e këtyre vizatimeve dhe skicave si dhe funksionimin e pajisjes ose sistemit mbrojtës;
- d) një listë të standardeve të zbatuara, plotësisht apo pjesërisht, dhe përshkrimet e zgjidhjeve të përshtatura për të plotësuar kërkesat e rregullit teknik ku nuk janë zbatuar standardet;
- e) rezultatet e llogaritjeve të bëra në projektim, kontrollet e kryera, etj.;
- f) raportet e provave të kryera.

17. Markimi “CE”

A. Markimi “CE”

Markimi “CE” i konformitetit përbëhet nga inicialet “CE” si paraqitet në formën e mëposhtme:



Nëse marka “CE” zvogëlohet ose zmadhohet, respektohen përmasat e vizatimit të mësipërm të shkallëzuar.

Komponentët e markës “CE” duhet të kenë të njëjtën përmasë vertikale dhe që nuk duhet të jetë më pak se 5 mm.

Ky dimension minimal mund të mos merren parasysh për pajisjet, sistemet mbrojtëse ose mjetet që referohen në pikën 1.2 dhe që janë të imëta.

B. Përmbajtja e deklaramit EC të konformitetit

Deklarimi “EC” i konformitetit përmban elementet e mëposhtme:

- a) emrin ose shenjën (logon) e identifikimit dhe adresën e fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- b) një përshkrim të pajisjes, sistemit mbrojtës ose mjetit që referohet në pikën 1.2;
- c) të gjitha kushtet përkatëse që plotëson pajisja, sistemi mbrojtës ose mjeti që referohet në pikën 1.2;
- d) ku kërkohet, emri, numri i identifikimit dhe adresa e organit të autorizuar/organizmi europian dhe numri i certifikatës “EC” të shqyrtimit të tipit;
- e) ku kërkohet, referimet e standardeve të harmonizuara;
- f) ku kërkohet, standardet dhe specifikimet teknike që janë përdorur;
- g) ku kërkohet, referimet e rregullave të tjera teknike që janë zbatuar;
- h) identifikimi i personit të autorizuar në emër të fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

18. Kriteret minimale që merren parasysh për autorizimin e organeve të autorizuara

18.1 Organi, drejtori i tij dhe stafi përgjegjës për kryerjen e provave të verifikimit nuk duhet të jenë projektues, fabrikues, furnizues ose instalues të pajisjeve, sistemeve mbrojtëse apo mjeteve, siç referohet në pikën 1.2, të cilat ata i inspektojnë dhe as përfaqësues i autorizuar i ndonjëres nga këto palë. Ata gjithashtu nuk duhet të përfshihen as drejtpërdrejt, dhe as si përfaqësues të autorizuar në projektim, ndërtim, tregtim apo mirëmbajtje të pajisjeve, sistemeve mbrojtëse apo mjeteve, siç referohet në pikën 1.2. Kjo nuk e përjashton mundësinë e shkëmbimit të informacionit teknik ndërmjet fabrikuesit dhe organit të autorizuar.

18.2 Organi dhe stafi i tij inspektimit kryejnë provat e verifikimit në shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës teknike dhe janë të lirë nga çdo presion dhe nxitje, veçanërisht financiare, që influencon në gjykimin e tyre ose në rezultatet e inspektimit, veçanërisht nga persona ose grupe personash me interes në rezultatet e verifikimit.

18.3 Organi duhet të ketë në dispozicion stafin e nevojshëm dhe të zotërojë mjetet e nevojshme për

të genë në gjendje që të realizojë plotësisht detyrimet administrative dhe teknike që lidhen me verifikimin; si dhe të ketë materialet e nevojshme që kërkohen për verifikime të veçanta.

18.4 Staf i përgjegjës për inspektim duhet të ketë:

- a) njohuri teknike dhe trajnim profesional;
- b) njohuri të nevojshme të kërkesave mbi provat që ata kryejnë dhe eksperiencë të mjaftueshme për kryerjen e provave të tilla;
- c) aftësi për hartimin e certifikatave, regjistrimeve dhe raporteve që kërkohen mbi vërtetësinë e kryerjes së provave.

18.5 Duhet të jetë garantuar paanshmëria e stafit të inspektimit. Shpërblimi i tyre nuk varet nga numri i provave të kryera ose nga rezultatet e këtyre provave.

18.6 Organi i autorizuar pajiset me sigurimin e përgjegjësisë në përputhje me nenin 14, paragrafi 2/d të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

18.7 Staf i organit të autorizuar ruan sekretin profesional lidhur me të gjithë informacionin e grumbulluar gjatë kryerjes së detyrave të tyre (përfshirë autoritetet kompetente kombëtare) të përcaktuara në këtë rregull teknik ose në akte të tjera ligjore ose nënligjore.

VENDIM

Nr.152, datë 11.2.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË PËR PAJISJET E VOGLA ELEKTRONIKE (DROSELA) DHE NDRIÇIM FLUORESHENT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat e efiçencës së energjisë për pajisjet e vogla elektronike (drosela) dhe ndriçimin fluoreshent”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK

MBI KËRKESAT E EFIÇENCËS SË ENERGJISË PËR PAJISJET E VOGLA ELEKTRONIKE (DROSELA) DHE NDRIÇIMIN FLUORESHENT

1. Ky rregull teknik zbatohet për droselat e llambave të ndriçimit fluoreshent.

2. Për qëllime të këtij rregulli teknik, droseli është pajisja që vendoset ndërmjet burimit të tensionit dhe një ose disa llambave me shkarkesë në gaze, e cila, në sajë të induktancës, kapacitetit ose të kombinimit të induktancës dhe kapacitetit, shërben kryesisht për të kufizuar rymën e llampës/ave që të mos kalojë një vlerë të caktuar, referuar më poshtë “droseli”.

Droseli mund të përbëhet prej një ose disa komponentëve të veçantë. Ai mund të përmbajë pajisje për të transformuar tensionin e ushqimit dhe pajisje të tjera që sigurojnë tensionin e rymës së parangrohjes, sigurojnë shkarkesën e ftohtë në gaze, redukton efektet stroboskopike, që rregullon faktorin e fuqisë dhe shuan zhurmat e interferencës.

3. Përfshihen nga ky rregull teknik tipet e droselave të mëposhtme:

- a) droselat e montuara brenda llambës;
 - b) droselat e projektuara në mënyrë specifike për ndriçuesat që montohen në orendi dhe që formojnë një pjesë të pazëvendësueshme të ndriçuesit, i cili nuk mund të testohet veçmas nga ndriçuesi.
4. Droselat klasifikohen në përputhje me pikën 16 të këtij rregulli teknik.

5 a) Gjatë fazës së parë, droselat vendosen në treg si elemente të veçanta ose si pjesë përbërëse të ndriçuesve, vetëm në qoftë se konsumi i energjisë së droselit në fjalë është më i vogël ose i barabartë me vlerën maksimale të energjisë në hyrje të qarkut drosel-llambë, siç përcaktohet në pikat 16, 17 dhe 18 për secilën kategori të droselit.

b) Gjatë fazës së dytë, droselat vendosen në treg si elemente të veçantë ose si pjesë përbërëse të ndriçuesve, vetëm në qoftë se konsumi i energjisë së droselit në fjalë është më i vogël ose i barabartë me vlerën maksimale të energjisë në hyrje të qarkut drosel-llambë, siç përcaktohet në pikat 16, 17 dhe 19 për secilën kategori të droselit.

6. Fabrikuesi i droselave, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për vendosjen e droselave në treg, është përgjegjës për të siguruar që çdo drosel i vendosur në treg si element i veçantë, ose si pjesë përbërëse e ndriçuesve, të përputhet me kërkesat e përcaktuara në pikën 5.

7. Nuk ndalohej, kufizohet ose pengohet vendosja në treg e droselave, si elemente të veçanta, ose si pjesë përbërëse të ndriçuesve, të cilat mbajnë markën “CE”, që tregon përputhjen e tyre me kërkesat e këtij rregulli teknik.

8. Droselat, si elemente të veçanta ose si pjesë përbërëse të ndriçuesve të cilat mbajnë markën “CE”, të kërkuar në pikën 12, prezumohen se janë në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, me përjashtim të rasteve kur ka të dhëna për të kundërtën.

9. Përveç atyre të parashikuara në pikat 12, 13 dhe 14, procedurat për vlerësimin e konformitetit të droselave, si elemente të veçanta ose si pjesë përbërëse të ndriçuesve dhe rregullat për vendosjen e markës së konformitetit “CE” duhet të jenë në përputhje me modulën A, të përcaktuar në pikën 20.

10. Fabrikuesi është përgjegjës për krijimin e dosjes teknike dhe ruajtjen e saj, për një periudhë jo më pak se 3 vjet, në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut.

11.a) Përmbajtja e dosjes teknike, referuar në paragrafin (c) të modulit A përfshin:

i) emrin dhe adresën e fabrikuesit;
ii) një përshkrim të përgjithshëm të modelit, i mjaftueshëm për identifikimin e qartë të tij;
iii) informacionet, përfshirë vizatimet ose skicat përkatëse mbi karakteristikat kryesore të projektimit dhe në veçanti për faktorët që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në konsumin e energjisë elektrike;

iv) instruksionet e funksionimit;

v) rezultatet e matjeve të konsumit të energjisë të kryera, sipas përcaktimit në paragrafin (c), të kësaj pike;

vi) detajet e përputhshmërisë së këtyre matjeve krahasuar me kërkesat e konsumit të energjisë, të përcaktuara në pikën 16.

b) Dosja teknike e krijuar në përputhje me kërkesat e rregullave të tjera teknike mund të përdoret për sa kohë ai përfshin edhe kërkesat e përcaktuara në paragrafin (a).

c) Fabrikuesi i droselave është përgjegjës për përcaktimin e konsumit të energjisë për çdo drosel sipas procedurave të specifikuara në SSH EN 50294 ose standarde të tjera të barazvlefshme me të, si dhe përputhshmërinë e pajisjes me kërkesat e pikave 5, 6 dhe 15.

12. Kur droselat vendosen në treg, si elemente të veçanta ose si pjesë përbërëse të ndriçuesve, ato duhet të mbajnë markën “CE”, e cila përbëhet nga inicialet “CE”. Marka “CE” vihet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në droselat dhe paketimi i tyre. Kur droselat vendosen në treg, si pjesë përbërëse të ndriçuesve, marka “CE” vendoset në ndriçuesit dhe paketimin e tyre.

13. Kur struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut konstaton se marka “CE” nuk është vënë në mënyrë të rregullt, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar është i detyruar t’i sjellë droselat në përputhje me këtë rregull teknik dhe të ndalojë shkeljet në përputhje me kushtet e vendosura nga kjo strukturë. Në rastin kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk është i vendosur në Shqipëri, personi i cili vendos droselat në treg, si elemente të veçanta ose si pjesë përbërëse e ndriçuesve, merr përsipër këto detyrime.

14. Kur droselat nuk janë në përputhje me këtë rregull teknik, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut merr të gjitha masat e nevojshme të parashikuara në ligjin nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, neni 17, për të ndaluar vendosjen në treg dhe shitjen e droselave në fjalë.

15. Vetëm pas mbylljes së fazës së parë (faza e dytë) energjia maksimale në hyrjen e qarqeve drosel-llambë duhet të jetë në përputhje me pikën 19, në veçanti në lidhje me pikat 5 dhe 6.

16. Kategoritë e droselave

Për të llogaritur energjinë maksimale në hyrje të qarqeve drosel-llambë për një drosel të dhënë,

droselat duhet së pari të klasifikohen sipas kategorive të përshtatshme nga lista e mëposhtme:

Kategoria	Përshkrimi
1	drosela për llambat e tipit linear
2	drosela për llambat e tipit kompakt me 2 tuba
3	drosela për llambat e tipit kompakt me 4 tuba të sheshtë
4	drosela për llambat e tipit kompakt me 4 tuba
5	drosela për llambat e tipit kompakt me 6 tuba
6	drosela për llambat e tipit kompakt me 2 D

17. Metodatat për llogaritjen e energjisë maksimale në hyrje të qarkut drosel-llambë për një tip të dhënë droseli

Efiçenca e energjisë së një qarku drosel-llambë përcaktohet nga energjia maksimale në hyrje të qarkut. Ky është një funksion i energjisë së llambës dhe tipit të droselit, për këtë arsye energjia maksimale në hyrje të qarqeve drosel - llambë i një droseli të dhënë përcaktohet si energjia maksimale e qarqeve drosel -llambë, me nivele të ndryshme energjie për secilën llambë dhe tip droseli. Termat e përdorura në këtë pikë i korrespondojnë përcaktimeve të SSH EN 50294 ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të.

18. Faza e parë – Viti i I-rë pas hyrjes në fuqi

Gjatë kësaj faze (viti i I-rë i hyrjes në fuqi të këtij rregulli teknik) energjia maksimale në hyrje të qarqeve drosel-llambë e shprehur në W përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria e droselit	Energjia e llambës		Energjia maksimale në hyrjen e qarkut drosel - llambë
	50 Hz	HF	
1	15 W	13,5 W	25 W
	18 W	16 W	28 W
	30 W	24 W	40 W
	36 W	32 W	45 W
	38 W	32 W	47 W
	58 W	50 W	70 W
	70 W	60 W	83 W
2	18 W	16 W	28 W
	24 W	22 W	34 W
	36 W	32 W	45 W
3	18 W	16 W	28 W
	24 W	22 W	34 W
	36 W	32 W	45 W
4	10 W	9,5 W	18 W
	13 W	12,5 W	21 W
	18 W	16,5 W	28 W
	26 W	24 W	36 W
5	18 W	16 W	28 W
	26 W	24 W	36 W
6	10 W	9 W	18 W
	16 W	14 W	25 W
	21 W	19 W	31 W
	28 W	25 W	38 W
	38 W	34 W	47 W

Për çdo rast që një drosel është projektuar për një llambë fuqia e së cilës ndodhet midis dy vlerave të treguara në tabelën e mësipërme, energjia maksimale në hyrjen e një qarku drosel-llambë llogaritet me metodën e interpolacionit linear midis të dy vlerave të energjive me të afërta të llambave të treguara në tabelë.

Për shembull, në qoftë se një drosel për kategorinë e llampës 1 klasifikohet për një llampe 48 W në 50 Hz, energjia maksimale në hyrjen e një qarku drosel-llambe do të llogaritet si më poshtë:

$$47 + (48 - 38) * (70 - 47)/(58 - 38) = 58,5 \text{ W}$$

19. Faza e dytë

Energjia maksimale në hyrjen e qarqeve drosel-llambë shprehet në W dhe përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria e droselit	Energjia e llambës		Energjia maksimale në hyrjen e qarkut drosel - llambe
	50 Hz	HF	
1	15 W	13,5 W	23 W
	18 W	16 W	26 W
	30 W	24 W	38 W
	36 W	32 W	43 W
	38 W	32 W	45 W
	58 W	50 W	67 W
	70 W	60 W	80 W
2	18 W	16 W	26 W
	24 W	22 W	32 W
	36 W	32 W	43 W
3	18 W	16 W	28 W
	24 W	22 W	34 W
	36 W	32 W	45 W
4	10 W	9,5 W	16 W
	13 W	12,5 W	19 W
	18 W	16,5 W	26 W
	26 W	24 W	34 W
5	18 W	16 W	26 W
	26 W	24 W	34 W
6	10 W	9 W	16 W
	16 W	14 W	23 W
	21 W	19 W	29 W
	28 W	25 W	36 W
	38 W	34 W	45 W

Në çdo rast që një drosel është projektuar për një llambë, fuqia e së cilës ndodhet midis dy vlerave të treguara në tabelën e mësipërme, energjia maksimale në hyrjen e një qarku drosel - llambë llogaritet me metodën e interpolacionit linear midis të dy vlerave të energjive më të afërta të llambave të treguara në tabelë.

Për shembull, në qoftë se një drosel për kategorinë e llambës 1 klasifikohet për një llambë 48 W në 50 Hz, energjia maksimale në hyrjen e një qarku llambë-drosel llogaritet si më poshtë:

$$45 + (48 - 38) * (67 - 45)/(58 - 38) = 56 \text{ W}$$

20. Moduli A

a) Ky modul përshkruan procedurat sipas të cilave fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, përmbush detyrimet e përcaktuara në paragrafin (b), garanton dhe deklaron që droseli plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markën “CE” mbi çdo drosel dhe harton me shkrim deklaratën e konformitetit.

b) Fabrikuesi krijon dosjen teknike të përshkruar në paragrafin (c) dhe ai ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, e mban atë në dispozicion të strukturës së mbikëqyrjes së tregut të paktën për një periudhë 3-vjecare nga data e prodhimit të droselës së fundit.

c) Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk ndodhen në Shqipëri, detyrimi për

mbajtjen në dispozicion të dosjes teknike është përgjegjësi e personit që vendos droselën në treg.

d) Dosja teknike duhet të mundësojë vlerësimin e përputhshmërisë së droselës me kërkesat e këtij rregulli teknik. Ajo duhet të mbulojë projektimin, prodhimin dhe funksionimin e droselit.

e) Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban një kopje të deklaratës së konformitetit, së bashku me dosjen teknike.

f) Fabrikuesi merr të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që procesi i prodhimit të garantojë që droselat e prodhuara të përputhen me dosjen teknike referuar paragrafit (b) të këtij moduli dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

VENDIM
Nr.218, datë 6.3.2009

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.862, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”, SHA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 168 e vijues e 181 e vijues, të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nga ky rregull bëjnë përjashtim kreditë, ndërmjet KESH, sh.a.-së, dhe Bankës Europiane të Investimit, në shumën 2,3 (dy presje tre) miliardë lekë, dhe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Botërore, në shumën 2,68 (dy presje gjashtëdhjetë e tetë) miliardë lekë, sipas specifikimeve, të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, detyrimet e të cilave nuk do t’i transferohen OSSH, sh.a.-së.”.

2. Pas pikës 5/2 shtohen pikat 5/3, 5/4 e 5/5, me këtë përmbajtje:

“5/3. Asetet e financuara nga kreditë afatgjata, të përfunduara gjatë vitit 2008, nga KESH, sh.a., për OSSH, sh.a.-në, në shumën 1,1 (një presje një) miliard lekë, t’i transferohen Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sh.a.-së, dhe të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës ta pasqyrojë këtë transferim në formën e uljes së kapitalit të KESH, sh.a.-së, dhe të rritjes së kapitalit të OSSH, sh.a.-së, përkatësisht në vlerën e përcaktuar më lart.

5/4. Detyrimet afatshkurtra, për blerjen e energjisë elektrike dhe tarifën e transferimit, që OSSH, sh.a., ka, respektivisht, ndaj KESH, sh.a.-së, dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), sh.a.-së, deri në shumën 1 (një) miliard lekë, të shuhen dhe të pasqyrohen si rritje kapitali e OSSH, sh.a.-së.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.

5/5. Shuma prej 0,53 (zero presje pesëdhjetë e tre) miliardë lekë, që i korrespondon pagimit të huave afatgjata, në vitin 2008, nga KESH, sh.a., të pasqyrohet si rritje kapitali për OSSH, sh.a.-në.

Autorizohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të kryejë veprimet e nevojshme, për pasqyrimin e këtij veprimi.”.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shtojca 1

Specifikimet e kredive:

1. Marrëveshja e kredisë (numër 3671) së zhvillimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e ristrukturimit dhe të rehabilitimit të

sektorit të energjisë elektrike e datës 26 qershor 2002, në shumën ekuivalente me njëzet e katër milionë të drejta të veçanta të tërheqjes (SDR) (24 000 000) ose 2,68 miliardë lekë, në periudhë maturimi njëzet (20) vjet dhe interes të barabartë me Libor plus 0,75% e ratifikuar me ligjin numër 8941, datë 19.9.21002.

2. Marrëveshja e kredisë ndërmjet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sh.a.) dhe Bankës Europiane të Investimit për projektin e përmirësimit të kapacitetit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, e datës 30 tetor 2001, në shumën tridhjetë milionë euro (EUR) (30 000 000) ose 2.3 miliardë lekë, me periudhë maturimi tetëmbëdhjetë (18)vjet dhe interes të barabartë me Euribor plus 0.75%.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.3.2009
Doli nga shtypi më 12.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 32 lekë